



HISTORIA DHE SHOQËRIA PËR KLASËN V

Anita Angellovska
Glikerija Ilioska

Historia dhe shoqëria për klasën V

Autore:

Anita Angellovska
Glikerijska Ilioska

Recensentë:

Besa Havziu-Ismaili
Aneta Soklevska
Violeta Shurbanovska

Ilustrimet: Anastasia Dimitrova

Redaktor: Solidar Sulejmani

Përkthyer nga gjuha maqedonase: Refail Sulejmani

Redaktor profesional i botimit në gjuhën shqipe: Solidar Sulejmani

Lektor: Refail Sulejmani

Rregullimi grafik dhe teknik: Leon Xhingo, Evgenija Pavlova — ARS STUDIO

Botues: MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË
SË VERIUT Rr. "Shën Kirili dhe Metodi" nr. 54, 1000 Shkup

Titulli i origjinal:

Историја и општество за V одделение
Анита Ангеловска
Гликерија Илиоска

Shtypi: Evropa 92 — Koçan

Tirazhi: 7011

Vendi dhe viti i botimit: Shkup, 2022

Me vendim për miratimin e tekstit mësimor në lëndën Historia dhe shoqëria për klasën 5
nr. 26-1514/1 të datës 03.11.2022 i miratuar nga Komisioni kombëtar i teksteve
mësimore

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

373.3.016:94(075.2)=163.3
373.3.016:316.3(075.2)=163.3

ANGELLOVSKA, Anita

Historia dhe shoqëria për klasën V / Anita Angellovska, Glikerijska Ilioska ; [Ilustrimet Anastasia Dimitrova ;
përkthyer nga gjuha maqedonase Refail Sulejmani]. - Shkup : Ministria për arsim dhe shkencë
e Republikës së Maqedonisë së Veriut, 2022. - 152 str. : илустр. ; 26 см

Превод на делото: Историја и општество за V одделение / Анита Ангеловска, Гликерија Илиоска

ISBN 978-608-273-169-8

1. Ilioska, Glikerijska [автор]

COBISS.MK-ID 58682373

HISTORIA DHE SHOQËRIA PËR KLASËN V

PËRMBAJTJA

TEMA 1 – INDIVIDË DHE SHOQËRIA

VLERAT ETIKE	5
Cilat janë vlerat etike?	5
Ndershmëri apo gënjeshtëri?.....	6
Shantazhi dhe ryshfeti – po ose jo?.....	7
Drejtësia kundrejt padrejtësisë.....	9
Ae dua të vërtetën?.....	11
Çfarë mësova?.....	13
SOCIALIZIMI.....	16
Çfarë është socializimi?.....	16
Individi dhe socializimi	17
Roli i normave shoqërore (sociale) në jetën e njerëzve.....	20
Faktorët e socializimit.....	22
Socializimi ndikon në formimin e personalitetit.....	25
PÛRKATËSIA NE GRUPE TË NDRYSHME.....	28
Kush jam unë?.....	28
Identiteti etnik dhe kombëtar.....	33
TË DREJTAT E NJERIUT	36
Të drejtat e njeriut dhe liria.....	36
Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut.....	38
Luftëtarët e shquar për të drejtat e njeriut.....	44
TË DREJTAT E FËMIJËS	46
Unë kam të drejtë t'i di të drejtat e mia.....	46
Të drejtat dhe përgjegjësitë e mia.....	50
Kur më shkelen të drejtat e mia?.....	52

TEMA 2 - POPULLSIA DHE KONTINENTET

ZGJERIMI I POPULLSISE NE TOKE	57
Ku dhe kur u shfaqën njerëzit e parë?.....	57
Llojet/tipat e popullsisë së vendit	61
ZBULIMET E MADHE GJEOGRAFIKE	67
POPULLSIA BOTËRORE	73
Sipërfaqja, numri i popullsisë dhe dendësia e popullimit.....	73
Popullsia/rritja natyrore	79
Migrimi i popullsisë	81
SHTETET MË TË MËDHA NË BOTË	83
Vendet më të mëdha në kontinente.....	83
Faktet për shtetet më të mëdha dhe për kryeqytetet e tyre.....	85
POPULLSIA, SIPËRFAQJA DHE VENDPOZITA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT.....	92

TEMA 3 - PARAHISTORIA DHE HISTORIA

PERIUDHAT HISTORIKE	97
Periudhat kohore.....	97
Ndarja e së kaluarës.....	100
Parahistoria.....	102
Paraqitja e letrës.....	110
Historia.....	113
LLOGARITJA E KOHËS GJATË HISTORISË.....	120
Kalendarët gjatë historisë.....	120
Kalendari Julian dhe Gregorian.....	124
BURIMET HISTORIKE	127
VENDZIBULIMENT E NJOHURA ARKEOLOGJIKE NË BOTË	131
VENDZIBULIMENT ARKEOLOGJIKE NË TERRITORIN E VENDIT TONË	145

Tema 1

Rezultatet e mësimi

Nxënësi do të aftësohet:

- të dallojë veprimet e këqija, padrejtësitë dhe gënjeshttrat kundrejt sjelljes morale/mirësjellje;
- të identifikojë faktorët e socializimit dhe të shpjegojë se si ndikojnë në formimin e personalitetit;
- të bëjë dallimin ndërmjet përkatësisë etnike dhe shtetërore/kombëtare dhe të shpjegojë se si përkatësia në këto dhe grupe të tjera shoqërore përcakton identitetin e çdo individi;
- të shpjegojë parimet themelore të të drejtave të njeriut, të lidhë të drejtat me përgjegjësitë dhe të njohë situatat e shkeljes së të drejtave të fëmijëve në jetën e përditshme.

Do të zhvillosh:

- qëndrim pozitiv ndaj përkatësisë kombëtare/shtetërore;
- qëndrim kritik ndaj pabarazisë, diskriminimit dhe racizmit;
- ndërgjegjësim për nevojën për të respektuar të drejtat e fëmijës.

INDIVIDI DHE SHOQËRIA

VLERAT ETIKE

- Çka janë vlerat etike?
- Ndershmëria, vërtetësia apo gënjeshttra?
- Shantazhi dhe rryshfeti - po apo jo?
- Drejtësia kundër padrejtësisë
- A e dua të vërtetën?
- Çfarë mësova?

SOCIALIZIMI

- Çfarë është socializimi?
- Personaliteti
- Roli i normave shoqërore (sociale) në jetën e njerëzve
- Faktorët e socializimit
- Socializimi ndikon në zhvillimin e personalitetit

PËRKATËSIA NË GRUPE TË NDRYSHME

- Kush/Kush jam unë?
- Identiteti etnik dhe kombëtar

TË DREJTAT E NJERIUT

- Të drejtat dhe liritë e njeriut
- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut
- Luftëtarët e shquar njerëzorë

TË DREJTAT E FËMIJËS

- Unë kam të drejtë t'i njoh të drejtat e mia
- Të drejtat dhe përgjegjësitë e mia
- Kur shkelen të drejtat e mia?

VLERAT ETIKE



Mendo dhe përgjigju:

1. Cilat tipare te njerëzit janë pozitive? (Numëro ato të cilat i di).
2. Cilat tipare te njerëzit janë negative? (Numëro ato të cilat i di).
3. Përshkruaji tiparet për të cilat mendon se i zotëron.
4. Për cilin tipar ke dëgjuar se dikush e zotëron, ndërsa ti dëshiron ta zotërosh?

Çka janë vlerat etike?

Secili prej nesh ka tipare, veprime dhe sjellje që na pëlqejnë dhe që nuk na pëlqejnë. Ndonjëherë është vështirë të theksohet dhe të flitet për atë që na pëlqen te vetvetja dhe për atë që jemi krenar për shkak frikës se mos të dukemi si lavdërues, kurse për atë që jemi të pasigurt se si do të pranohet nga mjedisi. Në procesin e rritjes mësojmë se çka do të thotë e drejtë, sjellje etike dhe çka është e pahijshme.

Njerëzit e ndryshëm ndryshe mund t'i vlerësojnë tiparet tona dhe kjo është normale. Ndonjëherë është e rëndësishme të dimë se si na vlerësojnë të tjerët dhe të tentojmë të shikojmë nëpërmjet “syzeve” të tyre që ta kuptojmë më mirë sjelljen tonë dhe pasojat që i lëmë mbi të tjerët.

Qenësore është që t'i mësojmë idetë të cilat përcaktojnë se çka është ajo që llogaritet e rëndësishme, e vlefshme, e rëndësishme dhe e dëshirueshme. Këto ide paraqesin vlera me çka njerëzit i kuptojnë nga mosha më e vogël në mënyra të ndryshme: në shtëpi, në shkollë, nëpërmjet shoqërimit me shokë, nëpërmjet mediave etj. Sipas vlerave udhëhiqen me sjelljen dhe veprimet e tyre në shoqëri në të cilën jetojnë. Derisa **vlerat paraqesin ide për atë se çka është e drejtë ose e gabuar, normat paraqesin rregullat e sjelljes për vlerësimin e vlerave.** Vlerat dhe normat së bashku e formojnë mënyrën e sjelljes së njerëzve në mjedisin e tyre. Vlerat që llogariten si etike (të drejta) janë: ndershmëria, vërtetësia dhe drejtësia. Përkundër tyre janë: gënjeshttrat, kushtëzimet, ryshfetet, shpifjet, padrejtësitë të cilat janë jo të drejta.

Në faqet e ardhshme nëpërmjet aktiviteteve do të mësosh që t'i njohësh dhe t'i dallosh vlerat pozitive etike nga vlerat jo etike dhe negative.

Nëpërmjet aktiviteteve të radhës do të argëtoheni, do të luani role dhe do të bëni dallimin mes veprave të këqija, padrejtësive dhe gënjeshtreve përkundër asaj që është morale/mirësjellje. Dramatizoni në grupe dhe pas çdo dramatizimi bisedoni/diskutoni për pyetjet e dhëna nën tekst.

Ndershmëri apo gënjeshtëri?

DETYRË SHTËPIE

ndershmëri, gënjeshtëri

Toni dhe Jehona janë nxënës të shkëlqyeshëm. Ata janë shokë të mirë dhe ulen në bankë të njëjtë. Në orën e historisë dhe shoqërisë mësuesja iu dha detyra shtëpie që të shkruajnë për jetën e njerëzve në të kaluarën. Toni, seriozisht e kuptoi detyrën e shtëpisë, bëri shumë përpjekje që ta kryejë detyrën e shtëpisë, ndërsa Jehona ka harruar t'i bëjë detyrat. Për detyrat e shtëpisë iu kujtua gjatë pushimit të madh, veç më ishte vonë. E nxori fletoren nga çanta e Tonit dhe në shpejtësi i kopjoi detyrat e tij të shtëpisë. Ora filloi.

Mësuesja: Nxënës, në këtë orë do t'i lexojmë detyrat e shtëpisë. Shpresoj se keni qenë të suksesshëm në hulumtimet tuaja. Jehona, a dëshiron të na lexosh detyrat e shtëpisë?

Jehona e lexoi detyrën e "saj" të shtëpisë, ndërsa Toni nuk mund t'u besojë veshëve të tij.

Mësuesja e lavdëroi Jehonën për detyrën e bërë dhe e thirri Tonin për ta lexuar. Ai ishte hutuar dhe nuk dinte se çka të bëjë.

Mësuesja: Tani mund të përcjellim detyrën e shtëpisë së Tonit!

Toni: Mësuese, përmbajtja ime nuk është aq e mirë, le të lexojë dikush tjetër.

Mësuesja: Atë duhet unë ta vlerësoj, apo jo Toni? Lexo!

Toni e lexoi përmbajtjen. Të gjithë në klasë u qeshën. Mësuesja ishte shumë e befusuar.

Mësuesja: Njëri nga ju të dy është kopjues. Kush e shkroi përmbajtjen dhe kush e kopjoi?

Jehona: Mësuese, unë e kam shkruar, ndërsa Toni ka kopjuar prej meje fare pa më pyetur. Toni uli kokën, por nuk tha gjë. Jehona është shoqja tij. Sigurisht ka shkas për sjellje të tillë.





Pyetje për diskutim:

1. Çfarë sjellje është përshkruar në tekstin dramatik?
2. Kush nuk ka vepruar me ndershmëri?
3. A keni qenë ndonjëherë pjesëmarrës ose jeni gjetur në një situatë të tillë?
4. Çfarë do të bënit po të ishit në vendin e Tonit? E çka në vendin e Jehonës?
5. Si do të ishte më mirë që kjo situatë të zgjidhej?

Ndonjëherë në jetë përjetoni situata në të cilat do të duhet të vendosni, a duhet të veproni me ndershmëri ose të gënjeni. Gjithnjë bëjeni zgjidhjen që të jeni i ndershëm/e ndershme. Gënjeshtria nuk ndihmon në zgjidhjen e ndonjë problemi, kurse as që do t'ju bëjë njeri më të mirë.

Detyrë:

Vendoseni veten në rolet e regjisorit. Ndahuni në dy grupe. Njëri grup duhet të “filmojë” film me veprim në të cilin do të tregojë ndershmëri, ndërsa grupi dytë me veprim gënjeshtre. Zgjidhni aktorët, skenën dhe ndani rolet në mes veti. Diskutoni sjelljen e pjesëmarrësve në rolet kryesore të “filmit”.

Shantazhimi dhe ryshfeti - po ose jo?

VËLLEZËRIT

Fatoni dhe Vetoni janë vëllezër, por nuk dallohen shumë nga karakteri. Fatoni është në klasë të tetë, nxënës i shkëlqyer, por është shumë përtac. Dhoma e tij shpesh herë është e parregulluar, në kaos total. Vetoni është në klasë të pestë. Për dallim nga Fatoni, ai nuk është shumë për nga mësimi, mirëpo dhoma e tij është gjithnjë e rregulluar. Këto dallime shpeshherë janë shkas për mosmarrëveshje, veçanërisht kur Fatoni vepron nga pozita e vëllait më të madh.

Fatoni: Veton, do të më vijnë shokët. Pastroma pak dhomën. Shihe se çfarë kaosi është këtu.

shantazhimi, ryshfeti



Vetoni: Nuk më shkon mendja.

Fatoni: Atëherë zhvendosu për disa orë në dhomën time, ndërsa ne do të shkojmë në dhomën tënde. Këtu është më pastër.

Vetoni: Nuk vjen parasysh. Çfarë përfitimi kam unë?

Fatoni: Në rregull. Ti pastroje dhomën, ndërsa unë gjatë asaj kohe do t'i bëj detyrat nga matematika.

Vetoni: Ashtu mundet.



Pyetje për diskutim:

1. Çfarë sjellje është shfaqur në tekst?
2. Kush ka treguar sjellje negative?
3. Çfarë vlere është shantazhi dhe ryshfeti?
4. Çfarë do të bënit nëse do të ishit në një situatë ku dikush do t'ju shantazhonte?

Shantazhi dhe ryshfeti janë vlera negative. Ato janë vlera korruptuese që janë të dëmshme te njerëzit dhe shoqëria. Shantazhi shpeshherë është një zhvatje me ndihmën e kërcënimeve.



Detyrë:

Lexoje situatën vijuese, mendo dhe sqaro:

1. Martini dhe Ajshja mësojnë në klasë të pestë dhe së bashku ulen në një bankë. Kur ata bënë testim nga matematika Ajshja e kopjoi detyrën të cilën nuk e dinte. Martini e vërejti atë, por asgjë nuk i tha. Ditën vijuese Martini i cili ishte kujdestar atë javë, kërkoi nga Ajshja që ta zëvendësojë atë tërë javën me gjithë obligimet e tij.
 - Cili nga personazhet ka treguar vlera negative etike?
 - Pse ashtu mendon?
 - Si do të kishe vepruar po të ishe në vendin e tyre?
2. Ajshja nuk u pajtua me Martinin dhe kërkoi nga Tariku, kryetar i bashkësisë së klasës, së bashku ta zgjidhin këtë çështje. Ai thirri mbledhje të bashkësisë së klasës në të cilën është vendosur që Ajshja të kërkojë falje për kopjimin, ndërsa Martini për shantazhin.
 - A ka vepruar drejt Tariku dhe pse ashtu mendon?
3. Përshkruaje një ngjarje e cila të ka ndodhur apo në të cilën ke qenë i shantazhuar ose ke dhënë ryshfet.



Drejtësia kundër padrejtësisë

Mendo dhe përgjigju:

1. Çfarë kuptimi kanë fjalët lojtar i drejtë, lojë pa hile, procedurë e drejtë dhe marrëdhënie e drejtë?
2. A je gjetur ndonjëherë në situatë të thuash: nuk është e drejtë/nuk ka drejtësi?
3. Si ndihesh kur të bëhet padrejtësi?
4. A vepron me drejtësi?

Detyrë:

Lexoni tekstin, pastaj diskutoni në klasë sipas pyetjeve të parashtruara nën tekst

GRUPET

Në orën e bashkësisë së klasës, mësuesi i klasës V-2 i radhiti nxënësit të ulen në grupe sipas numrit rendor të ditarit. Por, u tregua se kjo nuk është zgjidhje më e mirë, për arsye se mes nxënësve në grupe shpesh herë kishte mospajtueshmëri. Në grupin e parë kishte pesë vajza dhe një djalë, i cili ankohej se është i diskriminuar sipas gjinisë. Grupin e dytë e përbënin vetëm nxënësit me sukses më të dobët dhe për atë shkak nuk kishin mundësi në tërësi t'i përmbushnin detyrat të cilëve ua kërkonte mësuesi.

Grupi i tretë ishte i përbërë vetëm nga nxënësit e shkëlqyeshëm, të cilët gjithnjë të parët i kryenin detyrat e parashtruara, kurse kohën e mbetur e kalonin në bashkëbisedim. Kështu, që u pengonin nxënësve të tjerë në klasë. Nxënësit iu drejtuan udhëheqësit të paraleles, me kërkesë që të bëjë shpërndarje të re nëpër grupe, për arsye se kështu nuk funksiononte mirë.

Nxënësi i parë: Mësues, Ju lutem të më ndërroni vendin nga ky grup, sepse vajzat fare nuk bashkëpunojnë me mua.

Nxënësi i dytë: Edhe unë gjithashtu. Ne jemi këtu vetëm nxënës të dobët, ndërsa në grupin tjetër të gjithë janë të shkëlqyeshëm. Grupi ynë gjithnjë ngel mbrapa të tjerëve.

Drejtësi, padrejtësi



Mësuesja: Nxënës, unë veç më i kam formuar grupet! Nuk më intereson! Nuk kam kohë për këto imtësi! Hapni librat në faqen 34!

Të nesërmen në klasë shpërtheu përleshja.



Pyetje për diskutim:

1. Çfarë sjellje është paraqitur në tekst?
2. Si ka vepruar mësuesja në këtë rast?
3. Si mund të drejtohet padrejtësia?
4. Si do të kishe vepruar nëse do të bëhej një padrejtësi?

Çdo ditë në jetë ballafaqohesh me drejtësi dhe padrejtësi. Drejtësia është vlerë pozitive etike. Drejtësia është kur askënd nuk e dallon pa marrë parasysh aftësitë dhe mundësitë e tyre. Ajo mësohet nga mosha e re dhe ju lejon të bëheni person pozitiv.

Detyrë:

1. Përkujtohu në përrallën “Dhelpra dhe lejleku” dhe sqaro kush kujt i ka bërë padrejtësi? Çka duhej të bëjë dhelpra për veprimet e saja që të jetë e drejtë?
2. Përshkruaje situatën në të cilën të është bërë padrejtësi. Si je ndier atëherë? Çfarë ke dëshiruar të ndodhë? Si dhe kush e drejtoi padrejtësinë?



A e dua të vërtetën?



Mendo dhe përgjigju:

1. Çfarë do të thotë fjala shpifje?
2. A të ka ndodhur ndonjëherë dikush të shpifë për ty?
3. Si je ndjerë atëherë?
4. A ke dëshiruar ta tregosh të vërtetën, por nuk ke ditur si?

Detyrë:

Lexoni tekstin dhe pastaj diskutoni në klasë sipas pyetjeve të dhëna nën të.

FILMI

Marku dhe Kate janë vëlla e motër. Ata shpeshherë hynë në konflikt për shkaqe të ndryshme. E premte pasdite, koha për pushim dhe kënaqësi. Kate shkon në dhomën e fëmijëve me qëllim që të shikojë filmin më të ri në DVD. Por, filmi ka “avulluar” diku. Ajo supozon se kush është fajtor.

Kate: Markooo! Ku është filmi ri?!

Marku: Çka bërtet, ia dhashë Bojanit ta shikojë!

Kate: Si ke guxuar t'ia japësh pa më pyetur?!

Marku: Si jo. Ti do të më tregosh! Bojani është shoku im, përvetë asaj unë jam më i madh se ti.

Kam të drejtën e vendosjes se çfarë do të bëj me filmin.

Kate: Menjëherë ta sjellësh ose do t'i tregoj nënës!

Marku e kapi për flokë Katen, kurse ajo mbrohej. Përfundojnë me grindje dhe bërtitje. Hyri e ëma e tyre dhe i pyet çfarë ka ndodhur.

Marku: Mami, Kate më kapi për flokë!

E ëma: Kate, pse e lëndove yt vëlla?

Marku: Nuk e di çka i ndodhi, përnjëherë u hidhërua dhe më kapi për flokë! (Marku qan, ndërsa Kate ngel e habitur se si ka mundur vëllai kështu ta shpifë).

Kate: Por, mami, unë... **E ëma:** Mos u arsyeto, e kape për flokë vëllain, fajtorë je.

E ëma del nga dhoma, Marku tallet, ndërsa Kate duke e vështruar Markun ngel e hidhëruar. Dëshiron ta tregojë të vërtetën, por nuk di se si.

shpifje,
vërtetëdashës





Pyetje për diskutim:

1. Çfarë sjellje është paraqitur në tregim?
2. A njihni ndonjë vlerë etike pozitive?
3. Cili prej personazheve në tekst përdori shpifje?
4. Si Kate mund ta dëshmojë të vërtetën?
5. Për cilin njeri themi se është i vërtetë?
6. Si do të kishe vepruar të ishe në vendin e Kates, por si në vendin e Markut?
7. Çfarë karakteristike tjetër mund të dallosh në tekst?

Vërtetëdashësia është dashuri ndaj të vërtetës. Ajo është vlerë etike e cila e përcakton veçorinë pozitive të ndonjë njeriu. Nëse dikush është dashamir i së vërtetës ai do të jetë i drejtë. Shpifja është veti negative dhe është bindje e padrejtë, fshehja ose shtrembërimi i së vërtetës paraqet përfitim të ndonjë fitimi.

Detyrë:

1. Sqaro si do të kishe vepruar në situatat vijuese:
 - a) Je dëshmitar i një sherri mes dy shokëve të klasës E di kush është fajtor, por nuk dëshiron të përzihesh në sherr. Mësuesja të pyet kush është fajtor. Heziton të tregosh, por njëkohësisht dëshiron ta thuash të vërtetën. Si do të veprime?
 - b) Në klasë dy shokët tuaj luanin me top. E thyen dritaren e klasës. Prandaj e shpifën shoqen e klasës e cila në atë kohë gjendej në oborr. E di se nuk është fajtore dhe padrejtësisht e kanë shpifur. Si do të veprime?



Çfarë mësova?

1. Binjaket



Tina dhe Kristina janë binjake dhe nxënëse në klasë të pestë. Shumë janë të afërta dhe nuk mundën njëra pa tjetrën. Ato kanë shumë gjëra të përbashkëta: lektyra, kompjuter, veshmbathje... së bashku mësojnë, së bashku i bëjnë detyrat e shtëpisë dhe ato shkollore. Kjo ndonjëherë është dhe lehtësim financiar për prindërit, por mund të paraqet dhe të bëhet shkas për konflikt.

Tina: Unë doja e para të hulumtoj për jetën e njerëzve në të kaluarën. Të thashë që në shkollë, kurse ti ishe e para që “grabite” kompjuterin.

Kristina: Ti e di se nesër kemi testim nga historia dhe shoqëria, ndërsa mua më dobët më shkon kjo lëndë. Deri sa unë mësoj, ti ushtro matematikë.

Tina: Tentova, por nuk po mundem të përqendrohem. Gjithnjë po mendoj për testin.

Kristina: Mirë, atëherë eja të mësojmë së bashku. Së pari do të ushtrojmë detyrat nga matematika, pastaj do të hulumtojmë nga historia dhe shoqëria.

Tina: Në rregull, ashtu do të jetë më mirë për të dyja.



Pyetje për diskutim:

1. Çfarë sjelljeje na është treguar në tregim?
2. Motrat a kanë vepruar ashtu si duhet?
3. Cilat vlera mund t'i vërejmë në tregim?

2. Aktivitete



Vlerat

Nga lista e vlerave të dhëna më poshtë, zgjidhi 10 vlera që janë personalisht me rëndësi për ty. Nëse ti mendon se ndonjë nga vlerat etua personale nuk është e përfshirë në listë, lirisht shtoje. Me këtë zgjidhje e bën listën tënde personale me vlera. Tash nga kjo listë zgjidhi 5 vlera të cilat janë më me rëndësi për ty. Pastaj mendo dhe nga këto 5 zgjidhi vetëm 3 vlera për ty që janë më të rëndësishme. Pasi t'i zgjidhësh 3 vlerat e tua personal, mendo pse këto tre janë më të rëndësishme, a ishte vështirë apo lehtë ta

bësh përzgjedhjen. Pastaj, me nxënësin afër teje bisedo për vlerat e zgjedhura. Gjatë orës mësimore diskutoni me tërë klasën rreth vlerave që janë me rëndësi për ju. Në diskutim merr pjesë edhe mësuesi/mësuesja juaj dhe shikoni nëse lista e vlerave të tij/saj është e ngjashme me tuajën ose nëdoshta krejtësisht e ndryshme.

Lista e vlerave personale:

PAQËDASHËS	GËZIM	KRIJIMTARI
PASURI	DASHURI	KURIOZITET
FAT	FAMILJE	SHËNDET
MIQËSI	DITURI	NDERSHMËRI
LAVDI	VËRTETËSI	PËRGJEGJËSI
PUSHTETI	PRANIM	SIGURI
DREJTËSIA	GUXIM	BASHKËPUNIM
?	?	?

3. Aktivitet/hulumto

Ndahuni në 6 grupe ose çifte. Ndani përvojat personale ose përvojat e shokëve tuaj për përjetim të ndonjë padrejtësie në shkollë. Pastaj zgjidhni një nga situatat e prezantuara për padrejtësinë për të cilën do të duhet të shkruani një shkresë protestuese ose ankesë drejtuar kryetarit të bashkësisë së klasës, kryetarit të bashkësisë së nxënësve, nxënësit - avokat mbrojtës, mësimdhënësit klasor, shërbimit profesional ose drejtorit. Në shkresë/ankesë, shkurtimisht duhet ta përshkruani situatën e padrejtësisë, të argumentoni si ka arritur deri te padrejtësia dhe të kërkonti që të ndërmerren masa. Pasi që secili grup e lexon shkresën/ankesën, zhvillohet diskutim për padrejtësinë, te kush duhet drejtuar pasi të bëhet padrejtësia dhe cila është mundësia për të qenë i mbrojtur.

4. Kontrolloni atë që keni mësuar me rrethim të shenjës e saktë apo e pasaktë sipas shembujve të dhënë:

1. Në shtëpi është e lejuar të gënjëhet	S	P
2. Respekti ndaj të tjerëve është vlerë	S	P
3. E ndershme është të paraqesësh padrejtësinë	S	P
4. E vërteta gjithnjë del në shesh	S	P
5. E padrejtë është ndaj dikujt të bësh shpifje	S	P
6. Ryshfeti është joligjor	S	P
7. E ndershme është të jesh i respektueshëm me të tjerët	S	P
8. Kur jemi në fatkeqësi kërkojmë ndihmë	S	P



SOCIALIZIMI



Mendo dhe përgjigju:

1. Me çka dallohesh nga shokët/shoqet e tua?
2. Cilën sjellje e keni të përbashkët dhe cilën jo të përbashkët?
3. Me çka dallohen dhe me çka janë njerëzit e njëjtë?
4. Me cilat rregulla të sjelljes duhet të respektohen njerëzit në mjedisin ku ata jetojnë?

Çfarë është socializimi?

Njerëzit mes vete dallohen në sjellje, në interesa, në shije të tyre, në shprehje, zakonet etj. Nuk ka dy njerëz tërësisht të njëjtë, as dy njerëz tërësisht të ndryshëm. Dallimet mes njerëzve e bëjnë botën më të pasur, më interesante dhe ofrojnë mundësi për të mësuar, plotësuar dhe zhvillim i ndërsjellë. Të gjithë njerëzit me karakteristikat e tyre kombinuese; sa i përket pamjes, aftësive, mendimeve, bindjeve, nevojave, interesave, kontribuojnë në pasurimin e bashkësisë.

Gjithsesi se njerëzit gjithashtu kanë një sërë ngjashmëri. Disa njerëz, edhe pse jetojnë në kushte dhe mjedise të ndryshme, mund të kenë interesa dhe pasion të njëjtë. Gjëja më e rëndësishme që njerëzit kanë të përbashkët janë nevojat e tyre për siguri, respekt, miqësi, dashuri, lojë, argëtim, vetë-aktualizim e të tjera.

Më përpara mësuam se vlerat dhe normat, së bashku e formojnë mënyrën si njerëzit të sillen në rrethinën e tyre. Ne i mësojmë rregullat e sjelljes që nga lindja, edhe atë: në familje, në shkollë, përmes bashkëmoshatarëve, përmes mediave dhe në mënyra të tjera. Të gjithë tentojmë të sillemi sipas rregullave të cilat i përshkruan shoqëria, sepse ajo pritet nga ne. Ato rregulla quhen **norma shoqërore ose sociale**. Normat shoqërore mësohen gjatë socializimit të fëmijës. **Socializimi është proces nëpërmjet të cilit fëmijët mësojnë si të bëhen anëtarë të shoqërisë.**

Nëpërmjet aktiviteteve dhe detyrave të mëposhtme do të mësoni se si fëmijët mësojnë të bëhen anëtarë të shoqërisë, cili është roli i normave shoqërore (rregullave të sjelljes) në jetën e njerëzve, cilët janë faktorët e socializimit dhe si ndikon socializimi në formimin e personalitetit.

Individi dhe socializimi

Aktivitet:



Çka më pëlqen dhe çka nuk më pëlqen mua?

Çka më pëlqen dhe çka nuk më pëlqen mua?

Mendo për atë se cilat nga tiparet, interesat, shprehitë, vlerat, marrëdhëniet me njerëzit, arritjet tuaja ju pëlqejnë dhe cilat nuk ju pëlqejnë. Pastaj plotësoje tabelën në faqen tjetër. Për secilën punë të theksuar, në çdo rresht, së pari vlerësoni veçmas nëse ju pëlqen apo jo, pastaj vlerësoni se si prindërit/tutorët, mësuesit dhe shokët tuaj e përjetojnë. Për shembull, nëse shkruan se ju pëlqen ajo se gjithnjë i ke detyrat e shtëpisë të shkruara, atëherë në kolonën “Unë” e shënon me + se ju pëlqen; te prindërit/kujdestarët ose mësimehmënit nëse vlerëson se ajo u pëlqen, e shënon në kolonën e përshtatshme me +; te shokët nëse vlerëson se ajo nuk u pëlqen e shënon në kolonën e përshtatshme me + (shih shembullin në tabelë). Pastaj, me nxënësin që është afër teje ndani përgjigjet. Prezantoni njëri-tjetrit nga dy gjëra që ju pëlqejnë, respektivisht që nuk ju pëlqen te vetja, pastaj një apo dy gjëra ku ekziston dallimi në përgjigjet që i ka dhënë nxënësi për vete në raport me vlerësimin e prindërve/tutorëve dhe shokëve.

Tabela: Çka më pëlqen dhe çka nuk më pëlqen mua?

KARAKTERISTIKAT, INTERESAT SHPREHITË, VLERAT, SJELLJA ME NJERËZIT, TË ARRITURAT	UNË		PRINDËRIT/ TUTORËT		MËSIMDHËNËSIT		SHOKËT/ SHOQËT	
	Më pëlqen	Nuk më pëlqen	Më pëlqen	Nuk më pëlqen	Më pëlqen	Nuk më pëlqen	Më pëlqen	Nuk më pëlqen
Gjithnjë i shkruaj detyrat e shtëpisë	+		+		+			+
Kur do të merremi vesh me shokët, zakonisht unë arrij i pari në vendin e caktuar dhe pastaj i pres shokët		+	+		+		+	
Nëse ma tërheq vërejtjen mësimdhënësi nuk tregoj në shtëpi								
Gjithnjë i përshtesha më të moshuarit								
Më pëlqen të punoj vetëm se sa në grup								

**Pyetje:**

1. Çka ishte më vështirë të shkruash - gjëra që të pëlqejnë te vetvetja ose ato që nuk të pëlqejnë? Pse? Sa shpesh i tregon gjërat që të pëlqejnë te vetvetja?
2. Si përballoresh me gjërat që nuk të pëlqejnë te vetvetja?
3. Sa i tregon? A përpiqeni t'i përmirësoni ato?
4. Ajo që gjithnjë na pëlqen, njëkohësisht a vlerësohet pozitivisht edhe nga të tjerët?
5. Cilat janë shkaqet për dallimet në vlerësim?

Çdo njeri ka karakteristikat e tij me të cilat dallohet nga të tjerët për nga pamja, karakteri, interesat, shprehjet etj. Këto karakteristika e përbëjnë personalitetin. Personaliteti është përmbledhje e të gjitha karakteristikave të njeriut (fizike, psikike, sociale). Këto cilësi ju bëjnë të veçantë. Ato ju bëjnë të ndryshëm nga njerëzit e tjerë. Sipas tyre jeni të njohur nga të tjerët.

Socializimi është proces të cilin fëmijët mësojnë se si të bëhen anëtarë të shoqërisë. Ajo fillon nga fëmijëria më e hershme dhe vazhdon tërë jetën. Individit a do t'i respektojë dhe a do t'i përdorur vlerat etike, a do të ketë karakteristika pozitive ose negative të personalitetit do të varet nga socializimi tij. Socializimi është faktor që ndikon në zhvillimin e personalitetit.



Detyrë:

Lexoni pyetjet, pastaj përgjigjuni. Krahasoni përgjigjet e shokëve të klasës:

1. Në shkollë mësimdhënësi para të gjithëve të lavdëroi se po përparon në mësim. Si do të kishte reaguar në lëvdatën? Supozoni si do të kishte reaguar shoku yt nëse nuk e lëvdon mësimdhënësi?
2. Në shtëpi ke tre topa të cilët nuk të nevojiten. Çfarë do të bëje me to?
3. Në klasë jeni marrë vesh që pasdite të shkoni te fusha e lojërave, por së pari duhet t'i shkruani detyrat e shtëpisë. Shoku yt nuk mund të arrijë që ta shkruajë detyrën e shtëpisë. Çfarë do të bësh në këtë rast?

Roli i normave shoqërore (sociale) në jetën e njerëzve



Mendo dhe përgjigju:

1. Tashmë i njihni disa rregulla të sjelljes në shkollë, shtëpi dhe në mjedisin e afërt. Numëroi dhe sqaroi ato.
2. Në tabelë shkruaji se çfarë lloj sjelljeje pret nga:

	Sjellje e pritur
Nxënësi	
Prindi	
Fqinji	
Miku	
Mjeku	
Polici	



Pyetje:

1. Nga e di se si duhet të sillen nxënësit, prindërit, fqinjët dhe njerëzit e tjerë në mjedisin tuaj?
2. Prej ku e di, ata si duhet të sillen?
3. Si quhen rregullat sipas të cilave duhet të sillen njerëzit?

Sjellja e pritur del nga rregullat që i përshkruan shoqëria. Ato rregulla quhen norma shoqërore ose norma sociale. Normat shoqërore (sociale) janë, për shembull: respekti ndaj të tjerëve, sjellje humane ndaj më të dobët dhe të pamundur, zgjidhja e problemeve nëpërmjet bisedës dhe marrëveshjes, tolerancë dhe solidaritet etj. Normat shoqërore mësohen gjatë socializimit. Ky është proces nëpërmjet të cilit nxënësit mësojnë si të bëhen anëtarë të shoqërisë.

Detyrë:

1. Shkruaj së paku tri norma sociale të cilave iu përmbahesh. Krahas tyre shkruaj shembuj të mosrespektimit të normave të njëjta në të cilat ke qenë dëshmitar. Pasi që do t'i shkruash, diskutosh në klasë çka ka sjellë dhe cilat janë pasojat e mospërmbajtjes së normave shoqërore (sociale).
2. Sqaro se çka do të kishte ndodhur deri sa dikush nuk iu përmbahet normave shoqërore (sociale). Sqarimin argumentoj me shembull.



Faktorët e socializimit



Mendo dhe përgjigju:

1. Kush është shoku yt i parë?
2. Me kë ke mësuar të shkruash?
3. Nga kush ke mësuar t'i përshëndesësh më të moshuarit?
4. Kush merr pjesë në socializimin tënd?
5. Çka mund të ndikojë në socializimin e individit?

Në socializimin e individit ndikojnë më shumë faktorë. Ajo është familja, grupi i bashkëmoshatarëve (shokët), shkolla dhe mediat.

Familja është mjedisi i parë në të cilin individ e fillon jetën dhe socializimin e tij. Në familje i fiton bazat e vlerave etike, të cilat më tej, siç rritet dhe zhvillohet si individ, i zhvillon edhe ato. Prandaj, është shumë e rëndësishme në çfarë mjedisi do të rritet fëmija.



Grupi i bashkëmoshatarëve (shokëve) janë faktor i cili ndikon në zhvillimin e individit. Fëmija pranon ndikime pozitive dhe negative nga shokët e tij.

Shkolla është vendi ku individ arsimohet dhe edukohet: fiton njohuri, shoqërohet, zhvillon shprehje dhe mëson t'i respektojë rregullat e jetës shkollore. Mediat janë pjesë e pandashme nga jeta dhe zhvillimi individual i njeriut. Nëpërmjet televizionit, radios, shtypit, internetit, individ ballafaqohet me informata të ndryshme, komunikon me disa prej tyre, gjithë kjo ndikon në zhvillimin e individit dhe shoqërimin tij.



**Pyetje:**

1. Si ndikon familja në socializimin e individit?
2. Përshkruani se si grupi juaj i bashkëmoshatarëve (shokëve) mund të ndikojë pozitivisht dhe negativisht tek ju.
3. Si ndikon shkolla në zhvillimin e socializimit tuaj?
4. Sqaro se si mediat ndikojnë pozitivisht dhe negativisht në socializimin tuaj.

Aktivitet:

Ndahuni në katër grupe dhe përgatituni për një debat. Secili grup do të punojë në njërin nga faktorët e socializimit: familja, shokët (bashkëmoshatarët), shkolla dhe mediat. Kështu, që të dilni me më shumë argumente, të mbështetur me shembuj nga realiteti, me çka të tjerëve duhet t'ua dëshmoni se faktori i “tyre” është më i rëndësishëm se fëmijët do të mësojnë a është mirë/keq për ta bërë dhe si do të sillen. Pastaj grupet radhazi tregojnë nga një shembull të argumentuar, çdo herë tjetër të përfaqësohet nga një anëtar i grupit tjetër. Secili e fillon argumentin e vet me fjalinë: familja/shkolla/shokët/mediat (varësisht nga grupi të cilit i takon) është me rëndësi/më me rëndësi për socializimin për arsye se... shëno një argument të pasqyruar me një shembull.

Diskutoni në çfarë mënyre faktorët e shoqërimit ndikojnë në zhvillimin pozitiv dhe negativ të karakteristikave të individit.

Komunikimi është shumë i rëndësishëm në socializimin e individit. Mënyra se si komunikoni pasqyron personalitetin tuaj.

Punëtorja

Ndahuni në çifte në mënyrë të rastësishme. Njëri nga çifti e merr rolin e “vizatuesit”, ndërsa tjetri të “sqaruesit”. Çiftet ulen të kthyer shpinë me shpinë, me çka “sqaruesi” është i kthyer kah mësimdhënësi/mësimdhënësja. Gjatë punëtorisë pjesëmarrësit nuk guxojnë të kthehen njëri kah tjetri ose anash. Vizatohet vizatimi në letër të bardhë (të madhe) ose në tabelë, ashtu që të jetë e dukshme për nxënësit “sqarues”.




Nxënësit “s qarues” e shikojnë vizatimin dhe përpiqen në mënyrën më të mirë të mundshme t`ua sqarojnë vizatimin partnerëve (“vizatueseve”) të tyre, kurse ata duhet ta vizatojnë në një letër të njëjtën gjë duke ndjekur udhëzimet e tij.

Kur të gjitha çiftet do të përfundojnë me punën e tyre, loja përfundon dhe fillon diskutimi. Pritet në klasë të ketë shumë zhurmë, sepse “s qaruesit” do të fillojnë të bërtasin duke ia kaluar njëri-tjetrit.



Pyetje për diskutim:

1. Nga shkaktohet suk sesi/dështimi juaj?
2. A ndiheni përgjegjës për rezultatet e arritura?
3. Faji (merita) i/e kujt është më i madh për dështimin ose suksesin eventual, është i “s qaruesit” ose i “vizatuesit”?
4. A do të ishit më të suksesshëm nëse vetë do ta zgjidhnit partnerin tuaj?
5. Çfarë roli ka pasur komunikimi mes çifteve për kryerjen me sukses të detyrës?
6. A do të ishit më të suksesshëm nëse grupet do të punonin ndaras e jo njëkohësisht?
7. Çka do të kishte ndodhur nëse lojtarët do të ishin përballë njëri-tjetrit e jo të kthyer shpinë me shpinë?
8. Suk sesi dhe dështimi i individit a varet gjithnjë vetëm prej tij?




(një sugjerim për një vizatim që duhet të vizatojnë nxënësit)

Socializimi ndikon në formimin e personalitetit

Aktiviteti 1:

Ndahuni në grupe të vogla ose në çifte. Mësimdhënësi iu ndan fletë pune, në qendër të saj është vizatuar një rreth në të cilin shkruan PERSONALITETI: sjellja ndaj njerëzve dhe ndaj punës, ndërsa rreth saj janë të vizatuar më shumë rrathë boshe. Në rrathët boshe shënoni tipare të ndryshme të individit nëpërmjet të cilit manifestohen mënyrat e ndryshme të sjelljes së individit ndaj njerëzve të tjerë ose ndaj punës (për shembull: bashkëpunues/bashkëpunuese - bashkëpunon me shokët/shoqet; i përmbushur/ e përmbushur - i përfundon detyrat në kohë). Në të njëjtën kohë tiparet nuk duhet të shënohen vetëm në gjininë mashkullore, por dhe në gjininë femërore (për shembull: bashkëpunues/bashkëpunuese)



Pyetje për diskutim:

1. Pse disa individë janë më bashkëpunues nga të tjerët?
2. Pse disa individë janë më punëtor nga të tjerët?
3. Çka ka ndikuar në zhvillimin e personalitetit të tyre?
4. Në çfarë mënyre ka ndikuar familja, shkolla, bashkëmoshatarët dhe mediat në zhvillimin e drejtësisë/vërtetëdashurisë dhe ndershmërisë?

Aktiviteti 2:

Lexo tekstin, pastaj diskuto sipas pyetjeve të parashtruara nën tekst:

“Lirimi ishte në klasë të pestë kur e panë duke kopjuar në testin nga matematika. Ai filloi të tregojë rezultate të dobëta nga matematika dhe prindërit iu kërcënuan nëse nuk i përmirëson notat, nuk do ta lejojnë të luajë në ekipin e basketbollit. Prandaj ai vendosi të kopjojë gjatë testimit. Kur fillon mësuesja ta pyesë, qysh në fillim kundërshtojë, por më në fund pranoi se i ka shkruar përgjigjet në shtëpi.

Prindërit e Bardhit u ftuan në mbledhje prindërore, Bardhi ishte i detyruar të ulej së bashku me prindërit e tij, mësuesja dhe drejtori u thanë që të bisedojnë për rregullat shkollore sa i përket kopjimit dhe gënjeshtreve. Rugës për në shtëpi i ati i tha se është i dëshpëruar, por nuk ka pritur shumë më tepër nga ai. Atë mbrëmje, Lirimi ndjeu sikur e tërë bota është kundër tij, por ai ndjehej edhe fajtor për zhgënjimin e prindërve të tij.

Gjatë fundjavës, Lirimi dhe familja e tij shkuan në kinema. Kur arritën te biletaria i ati i Lirimit kërkoi dy bileta për fëmijët, për Lirimin dhe vëllain e tij gjashtëmbëdhjetë vjeçar. Bardhi e shikoi vëllain e tij i cili në atë momente e kishte ngulitur shikimin poshtë, ai ngriti supet dhe shpresonte se shitësja e biletave nuk do ta vërejë se është më i rritur nga mosha e lejuar e biletave për fëmijë. Shitësja e shikoi me dyshim babanë dhe vëllain dhe u dha atyre dy biletat. Kjo ndodh sa herë që shkujnë në kinema, gjithë kjo kontribuon që Lirimi të ndjehet i çuditur. Pas filmit, rugës për në shtëpi, Bardhi e pyet të atin pse është në rregull të gënjeshtrojë dhe të mashtrosh për para në kinema, ndërsa nuk është në rregull për testin nga matematika. I ati iu përgjigj, ndonjëherë është në rregull të gënjeshtrojë deri sa askënd nuk e lëndon. Deri në fund të rugës Lirimi u bë ende më i hutuar. Mashtrimi në test nuk lëndon askënd. Ai nuk i vodhi detyrat e ndonjë shoku tjetër. Nëse mësuesja nuk e kapte bëri ai dallohet nga ajo që bëri rregullisht i ati? Dhe a duhet të heshtë herën tjetër që i ati të gënjejë?”



Pyetje për diskutim:

1. Cila është dilema e Lirimit?
2. Cilin mund ta lëndonte Lirimi me mashtrimin në test?
3. A ke parë ndonjëherë ndonjë të rritur, ose shok tëndin të kishte bërë diçka që ti mendon se nuk është në rregull? Çfarë bëre ti? Si ndihej në atë moment?
4. A mendon se Lirimi edhe një herë duhej të tentonte të bisedonte me prindin e tij në lidhje me gënjeshtrenë në kinema?
5. I ati Bardhit tha se në rregull është të bëhesh i pandershëm deri sa nuk e lëndon askënd. Çfarë mendon, kush tjetër ka mundur të lëndohet nga gënjeshttra e tij në biletari?
6. A ke ndjerë ndonjëherë se dëshiron të bësh (ose ke bërë) ndonjë punë të “keqe” sepse ke menduar se ia vlen ta bësh? A mendon ende se ia vlen?

Personaliteti formohet gjatë socializimit. Se si një person do të sillet ndaj të tjerëve dhe ndaj punës varet nga faktorët (familja, shokët, shkolla, media) që ndikojnë tek ai



Pyetje për diskutim:

1. Mendo nëse je ballafaquar ndonjëherë me ndikime negative të ndonjë faktori për socializim?
2. Si do t'i rezistosh ndikimeve negative nga faktorët e socializimit?
3. Çka mund të ndodhë nëse bie nën ndikimin negativ të ndonjë bashkëmoshatare tënd?

PËRKATËSIA NË GRUPE TË NDRYSHME

Kush jam unë?

Aktiviteti 1:

Përfundo fjalitë duke e shfrytëzuar paraqitjen e mësuesit/mësueses si model:

- Unë jam (djalë apo vajzë).
- Familjen time e përbëjnë (shënoi anëtarët e familjes).
- Unë jam nxënës në klasën (Shënohet paralelja)
- Mësoj në shkollën fillore.....
- Unë jam (shënohet përkatësia etnike: maqedonas/e, shqiptar/e, serb/e, rom/e, turk/e, boshnjak/e, vllah/e.)
- Unë jam nga (shënohet emri i shtetit).

Pas përfundimit të detyrës, me ndihmën e mësimitdhënësit/mësimitdhënëses grupohuni sipas elementeve të ndryshme nga përshkrimi dhe do të qëndroni në “grupin” tuaj në vendin hapësinor të cilin së bashku do ta caktoni.

Së pari grupohuni djem e vajza. Pastaj grupohuni sipas klasës ku mësoni, pastaj sipas shkollës ku mësoni, mandej sipas përkatësisë etnike që i takoni, kurse në fund sipas shtetit në të cilin jetoni.

Keni vërejtur se mes njerëzve ekzistojnë ngjashmëri dhe dallime në përkatësitë e grupeve të caktuara. Për shembull: përkatësinë e një familjeje konkrete e ndajnë numër i vogël nxënësish, përkatësinë e një paraleleje të caktuar e ndajnë numër më i madh i nxënësve, përkatësinë e një shkolle të caktuar edhe më shumë. Përkatësinë e një profesioni të caktuar e ndajnë shumë njerëz. Numri është i madh i njerëzve që i përkasin një grupi etnik, ndërsa të një shteti të caktuar edhe më shumë, të një gjinie të caktuar edhe më shumë njerëz. Do të përmbyllim se përkatësia e grupeve e përcakton identitetin e tyre.

Për shembull: nuk është njëjtë nëse një nxënës është në klasë të tretë apo në të pestën të shkollës fillore ose në ndonjë klasë të shkollës së mesme. Nuk është njëjtë nëse dikush punon si mësimdhënës apo si polic, prej çka më tej varet raporti i tyre ndaj grupeve të ndryshme. Njerëzit ndjejnë lidhshmëri më të madhe ndaj anëtarëve të grupeve të cilave u takojnë se sa ndaj të tjerëve. **Për shembull:** prindërit/tutorët më shumë i mbrojnë fëmijët për të cilët përkujdesen, se sa të tjerët, gratë lehtë solidarizohen njëra me tjetrën kur janë të sulmuara nga burrat dhe anasjelltas, njerëzit që jetojnë në një shtet më shumë bëjnë tifo për kombëtaren e tyre se sa për tjetrën etj.

Aktiviteti 2:

Së pari mendo për pyetjen: Kush jam unë?, pastaj plotësoi fjalitë:

Interesat e mia kryesore janë.....

Vlerat e mia kryesore janë.....

Nevojat e mia kryesore janë.....

Ngjarjet më të rëndësishme në jetën time janë.....

Tiparet më të rëndësishme që i kam fituar nga më të afërmit janë.....

Përvoja ime më e rëndësishme nga shkolla është.....

Shokët e mi më të mirë janë.....

Pasioni im i parapëlqyer.....

Kënga ime e parapëlqyer është.....

Kuptuat se nocioni identitet në fakt është përgjigje e pyetjeve: Kush jam unë? Cilat tipare më bëjnë të veçantë dhe të ndryshëm nga njerëzit e tjerë? Cilat tipare të mia janë të përbashkëta ose të ngjashme me njerëzit e tjerë?

Identiteti i një personi fillon të krijohet nga momenti i lindjes dhe zhvillohet gjatë jetës së tij. Vetëdija për vete zhvillohet nga mosha më e hershme, kur fillon të ndërtohet identiteti personal dhe grupor i njeriut.

Formimi i identitetit të një personi varet nga faktorë të ndryshëm. Disa nga faktorët janë të tillë që identiteti vetë i përcakton, pasi që varen nga nevojat, dëshirat dhe interesat e tij në moshë të caktuar.

Ky është fillimi i procesit në ndërtimin e identitetit personal dhe grupor, vijon një periudhë në të cilën interesat, dëshirat dhe nevojat e llojllojshme kanë rëndësi të ndryshme për individin, e gjithë kjo ndryshe ndikon në zhvillimin e identitetit të tij. Për shembull, vetë individit dhe mjedisi i tij mund të ndikojnë në zgjedhjen e vendbanimit, kulturës, arsimit, profesionit, marrëdhënieve të partnerit dhe miqësisë, përkatësisë në grupe shoqërore etj. Por, disa faktorë që ndikojnë në formimin e identitetit, paraprakisht janë të përcaktuar. Për shembull: gjinia, tiparet fizike, vendi i lindjes etj.

Detyrë:


Sipas cilave karakteristika, identiteti dallohet në personalitetet vijuese: Vesna është krishtere e cila jeton në Shqipëri, ndërsa i takon etnitetit maqedonas, kurse Fatmiri është mysliman i cili i takon etnitetit shqiptar dhe jeton në Maqedoni të Veriut?

1. Kombëtare, etnike, gjinore dhe fetare.
2. Kombëtare, etnike, gjinore dhe familjare.
3. Etnike, familjare, gjinore dhe fetare.
4. I moshuar, fetare, gjinore dhe familjare.

Identiteti personal dhe grupor

Identiteti personal është veçanti e jonë, specifike, unike dhe ndryshe në raport me njerëzit e tjerë. Në veçantinë tonë, siç përmendëm, ka tipare që janë në tërësi ndryshe nga njerëzit e tjerë dhe varen nga dëshirat, nevojat dhe interesat tona, por ka tipare që na bëjnë të ngjashëm me njerëzit e tjerë. Ato tipare e formojnë identitetin tonë grupor.

Identiteti personal





Identiteti grupor përfitohet dhe me lindje, por zhvillohet me moshën e njerëzve dhe nevojat e tyre që i përkasin grupeve të ndryshme, interesat e të cilëve janë të përbashkëta dhe i ndajnë bashkërisht. Me moshën ndryshon edhe identiteti i secilit njeri, individual dhe ai grupor. Për shembull, në këtë moment ju njëkohësisht i takoni më shumë grupeve të ndryshme: grupit fëmijësh të moshës 10 vjeç, grupit të nxënësve, fqinjëve, shokëve, anëtarëve të klubeve sportive, seksioneve, klubeve rinore, bashkësisë së nxënësve, grupit të tifozëve, përfaqësuesve të një religjioni të caktuar, grupit etnik, dëgjuesit e një lloji të caktuar muzike etj.

Sipas të numëruarave, keni parë se përkatësia e grupeve të cilave u takon mund të jenë formale dhe joformale, në pajtueshmëri me interesin. Ndjenja e veçantisë së anëtarëve që i përkasin ndonjë grupi të caktuar social dhe pranimi asaj gjëje që atë e dallon nga të tjerët e përcakton identitetin grupor. Përveç ndjenjës për mbrojtje, përkatësia e një grupi të caktuar është e ndërlidhur me emocione të tjera shumë të rëndësishme: krenaria, turpi, kënaqësia, frika, fati, pikëllimi, dashuria etj. Për shembull: Kur jemi pjesë e grupit të tifozëve të ekipit sportiv dhe ekipi e humb ndeshjen ne jemi të pikëlluar, ndërsa kur fiton ne jemi krenarë dhe të lumtur. Çfarë rëndësie do t'i japim identitetit të caktuar grupor, varet nga situata në të cilën gjendemi.

Gjithë kjo mund të sqarohet në mënyrën e mëposhtme:

- Luani është mashkull, nxënës, 10 vjeç, është vëllai më i madh, nga Manastiri. Se sa i rëndësishëm do të jetë njëri prej këtyre identiteteve për të, varet nga situata konkrete në të cilën ndodhet. Në situatë kur një anëtar i kombëtares sportive në ndeshje ndërkombëtare, ai paraqitet se është nga Republika e Maqedonisë së Veriut. Nëse bisedon me shokun për muzikë, ai ndan informatën se parapëlqen muzikë klasike. Kur është në shtëpi, si vëllai më i madh i ndihmon motrës më të vogël rreth detyrave të shtëpisë dhe përgatit sandviçë të mirë. Pra, cilat nga këto identitete të tij grupore do të jenë të rëndësishme në një situatë të caktuar që ai ta theksojë, ai ndryshon në varësi të situatës.



Detyrë:

Mendo për atë se cilët janë pesë faktorët kyç që ndikojnë në ndërtimin e identitetit tënd? Disa nga faktorët që ndikojnë në këtë proces janë: gjinia, mosha, pamja, origjina, familja, shëndeti, tiparet e individit, përvojat, vlerat, qëllimet, vendimet, interesat, stili jetësor, qëndrimi i të tjerëve ndaj teje (prindit/tutorit, shokëve, mësimdhënësit, trajnerit...), grupet e ndryshme sociale etj.

Aktiviteti 2:

Imagjino se duhet dikujt t'i thuash kush je, duke i përdorur vetëm tre nga identitetet e ofruara që më së miri të përshkruajnë. Pas zgjedhjes së tri kategorive, renditi sipas rëndësisë, ashtu që, me numrin 1 e përcakton fushën të cilën e vlerëson si më të rëndësishme kur duhesh të prezantohesh, me numrin 2 më pak e rëndësishme dhe me 3 krejtësisht pak e rëndësishme.

Unë...		Renditi prej 1 deri 3
maqedonas/e, shqiptar/e, turk/e, vllah/e, serb/e, rom/e, boshnjak/e, (plotëso)_____	tjetër	
prej _____ (shëno shtetin)		
prej _____ (shëno vendin, fshat/qytet)		
sportist/e		
mashkull/femër		
nxënës/e		
djalë/vajzë/vëlla/motër/fëmijë i vetëm		
artist/e		
lojtar/e		
njeri		

Identiteti etnik dhe kombëtar

A e keni ditur se

Në botë ekzistojnë mbi 5000 identitete etnike (p.sh: italianë, maqedonas, shqiptarë, turq, finlandezë, romë, punxhabi, zulu, tutsi, kurdë etj.), por nuk ka aq shumë identitete kombëtare, pasi janë vetëm rreth 200 shtete.



Identiteti etnik i një personi ndërlidhet me përkatësinë e tij ndaj ndonjë grupi etnik, ndërsa identiteti kombëtar me përkatësinë ndaj ndonjë shteti të caktuar. Pjesëtarët e grupit të caktuar etnik i lidh e kaluara e përbashkët, origjina, tradita, që i bën fuqishëm të jenë të lidhur mes vete. Ngjashëm me identitetin etnik është ai kombëtar.

Identiteti kombëtar është pjesë e rëndësishme e identitetit grupor i cili rrjedh nga ndjenja e përkatësisë së ndonjë shteti të caktuar, në të cilin ka mundësi të jetojnë më shumë grupe etnike. Të drejtat dhe obligimet e përbashkëta ndaj shtetit na identifikojnë si qytetarë të ndonjë shteti.

Qytetari zhvillon ndjenjë të përkatësisë ndaj shtetit tij, ndaj vlerave që ajo i inkurajon dhe ndaj njerëzve të tjerë që jetojnë në të dhe ata i ndajnë ato vlera. Shteti me ato vlera i inkurajon qytetarët e vet të zhvillojnë ndjenja të përkatësisë ndaj tij.



Republika e Maqedonisë së Veriut është shtet i të gjithë atyre që jetojnë në të dhe Kushtetuta, si ligj suprem, ua garanton mbrojtjen e identitetit etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar.



Hulumto:

Punoni të ndarë në katër grupe. Grupi i parë shkruan se çka dini për gjuhën, grupi dytë për ushqimet tradicionale, grupi i tretë për muzikën popullore, kurse grupi i katërt për religjionet e grupeve të ndryshme etnike që jetojnë në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Kërkoni ndihmë nga mësimdhënësi dhe përgatitni një prezantim. Pastaj, në kuadër të grupeve të njëjta, në një fletë të veçantë në njërën anë, vizatoni flamurin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërsa në anën tjetër shënoni se çka ju bën krenar që jeni qytetar i shtetit (për shembull: karakteri multietnik, bukuritë natyrore, ndonjë tipar i përbashkët i qytetarëve, siç janë: mikpritja, solidariteti...). Pasi të keni përfunduar, prezantoni atë që keni shkruar para të tjerëve. Diskutoni dhe këmbeni publikisht përfundimin se: Qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut dallohen sipas përkatësisë etnike, por ndajnë të njëjtin shtet, respektivisht përkatësinë kombëtare.

Aktivitetet

Punoni të ndarë në grupe për t'iu përgjigjur pyetjeve të përgatitura nga mësimdhënësi/ja, të cilat janë të theksuara në dy fletë të mëdha letre.

Në krye të njërës shkruhet: Shteti i Republikës së Maqedonisë së Veriut respekton qytetarët e vet për derisa i siguron:..., kurse në anën tjetër: Qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut respektojnë vendin e tyre duke:... Shkruani përgjigjet në fletët e mëdha në mënyrë që grupet një nga një do t'i përgjigjen në një fletë dhe një përgjigje në fletën tjetër. Çdo nxënës në grup duhet të shkruajë diçka në të dyja fletët. Në përgjigjet e përsëritura grupet vendosin një shenjë të veçantë (për shembull: një yll). Në fund mësuesi/ja lexon atë që shkruhet në fletë dhe së bashku nxjerrin përfundime se shteti i respekton qytetarët (për shembull: i ofron arsimim, trajtim mjekësor, të folurit në gjuhën e tyre amtare, mundësi punësimi, energji elektrike dhe ujë) dhe se ata respektojnë shtetin (për shembull: respektojnë simbolet shtetërore, ligjet, ndihmojnë bashkëqytetarët).

Kontrolloni atë që keni mësuar duke rrethuar shenjën e saktë (S) ose e pasaktë (P) sipas shembujve të dhënë:

1. Vetëdija zhvillohet që në moshë të re.	S	P
2. Identiteti personal është veçantia jonë.	S	P
3. Identiteti i grupit fitohet vetëm me lindje.	S	P
4. Identiteti kombëtar përcakton përkatësinë ndaj shtetit.	S	P
5. Qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut dallohen sipas përkatësisë etnike, por ndajnë të njëjtin shtet, përkatësisht përkatësinë kombëtare.	S	P



TË DREJTAT E NJERIUT**Të drejtat dhe liritë e njeriut**

Për të mbijetuar, njerëzit duhet të plotësojnë një sërë nevojash. Të tilla janë nevojat për ngrohje, ushqim, ujë, shtëpi, shëndet, nevoja sigurie. Njerëzit, gjithashtu kanë nevojë për bashkëpunim dhe miqësi me njerëzit e tjerë, nevojë për respekt, nevojë për sukses personal, sepse duan të konkurrojnë, të provojnë dhe të përmirësohen. Nevojat janë të gjitha ato gjëra pa të cilat njerëzit nuk mund të jetojnë dhe të kenë një jetë të denjë. Njerëzit kanë edhe dëshirë. Këto janë gjërat që dëshirojmë. Ndonjëherë ato përputhen me nevojat, por ndonjëherë janë thjesht objekte, udhëtime apo ide të dëshiruara. A mendoni se të drejtat e njeriut i realizojnë nevojat apo dëshirat e njerëzve?

Shumë shpesh njerëzit përdorin fjalët të drejta dhe liri të njeriut, duke dashur të theksojnë se diçka u lejohet me ligj dhe askush nuk mund t'ua mohojë. Njeriu është arsyeja e ekzistencës së të drejtave të njeriut, sepse ato janë krijuar për të.

Të drejtat e njeriut janë rregullat dhe liritë me të cilat shteti e përcakton sjelljen e njerëzve në bashkësi për të kënaqur nevojat e tyre. Kur shteti njih dhe mbron nevojat e njeriut, atëherë nevojat shndërrohen në të drejta të njeriut.

Aktivitet

Punët e ndara në grupe. Secili grup do të marrë një komplet prej njëzet kartelash të shkruara ose të ilustruara dhe disa kartela të zbrazëta. Secila nga kartelat e shkruara përfaqëson një nevojë (për shembull: ajër të pastër, arsim, ushqim të shëndetshëm, kujdes shëndetësor) ose një dëshirë (për shembull: dhomën e vet, kompjuter, biçikletë, para xhepi).

Detyra juaj e parë është të shikoni kartelat dhe nëse mendoni se mungon diçka që ju pëlqen dhe që është shumë e rëndësishme për ju, shkruani ose vizatoni atë në kartelat e zbrazëta.

Pasi të keni plotësuar kartelat, lini mënjanë tetë kartela që mund t'i dorëzoni nëse do t'ju duhen. Pasi mësuesi/ja t'i mbledhë kartelat nga të cilat po hiqni dorë, grupet do të duhet të heqin dorë edhe nga tetë kartela të tjera. Secili grup i ngjit kartelat e mbetura në një fletë dhe ua prezanton të tjerëve. Mësuesi/ja, së bashku me ju, do të përcaktojë se cilat janë gjërat që i përsërisni në të gjitha grupet, pastaj diskutoni se cilat gjëra ishin më të lehta për t'u hequr dhe cilat ishin më të vështira dhe pse. Mësuesi/ja do të konfirmojë nëse kartelat tregonin dëshira dhe nevoja dhe së bashku do të përcaktoni nëse ato që janë mbajtur janë nevoja apo dëshira.




Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut



Mësuam se çfarë paraqesin të drejtat e njeriut. Parashtrohet pyetja, a i kanë pasur njerëzit gjithmonë këto të drejta? A ishin të gjithë njerëzit të barabartë dhe me të drejta të barabartë? A i kanë sjellë të gjitha vendet menjëherë të drejtat e njeriut?

Në të kaluarën njerëzit nuk ishin të barabartë në të drejtat e tyre. Kishte dallime të mëdha midis të pasurve dhe të varfërve, burrave dhe grave, fëmijëve dhe të rriturve, njerëzve të racës së zezë dhe të bardhë. Këto dallime ishin në baza të ndryshme. Njerëzit vriteshin pa mbajtur askush përgjegjësi dhe disa njerëz kanë vuajtur shumë për shkak të sjelljes së njerëzve të tjerë.

Për herë të parë në historinë e njerëzimit njerëzit nga e gjithë bota kanë rënë dakord për të drejtat e njeriut në nivel ndërkombëtar, si sistem rregullash, të cilat janë universale të pandashme dhe vlejnë për të gjithë njerëzit në botë, pavarësisht moshës, gjinisë, racës, fesë dhe përkatësisë sociale. Ky dokument shumë i rëndësishëm quhet Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut dhe është votuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara si rekomandim për të gjitha vendet e botës. Shkaqet ishin vuajtjet e njerëzve gjatë Luftës së Dytë Botërore. Deklarata Universale u votua më 10 dhjetor të vitit 1948 në Paris dhe përmban 30 nene, pra rekomandime me të drejtat e njeriut, të drejtat dhe liritë kundër çdo lloj diskriminimi. Kjo është arsyeja pse 10 dhjetori është Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut



Neni 1

Të gjithë njerëzit lindin të lirë dhe të barabartë në dinjitet dhe në të drejta. Ata kanë arsye dhe ndërgjegje dhe duhet të sillen ndaj njëri-tjetrit me frymë vëllazërimi.

Neni 2

Secili gëzon të gjitha të drejtat dhe liritë e shënuara në këtë Deklaratë pa kurrfarë kufizimesh sa i përket racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, besimit fetar, mendimit politik ose bindjes tjetër, origjinës kombëtare a shoqërore, pasurisë, lindjes ose status tjetër. Asnjë dallim nuk do të bëhet në bazë të statusit politik, juridik ose ndërkombëtar të shtetit ose vendit të cilit i përket çdo njeri, qoftë kur shteti ose vendi është i pavarur, qoftë nën kujdestari, qoftë jo vetëqeverisës ose që gjendet në çfarëdo kushtesh të tjera të kufizimit të sovranitetit.

Neni 3

Secili ka të drejtë të jetojë, të jetë i lirë dhe të ketë siguri.

Neni 4

Askush nuk duhet të jetë skllav ose i nënshtuar, skllavëria dhe tregtia e skllavëve janë të ndaluara në të gjitha format.

Neni 5

Askush nuk duhet t'i nënshtrohet torturës, veprimit ose dënimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues.

Neni 6

Secili ka të drejtë të njihet kudo qoftë si personalitet para ligjit.

Neni 7

Të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe kanë të drejtë pa asnjë diskriminim të mbrohen barabartë nga ligji. Të gjithë kanë të drejtën e mbrojtjes së barabartë kundër çdo diskriminimi që cenon këtë Deklaratë, si dhe kundër çdo nxitjeje për një diskriminim të tillë.

Neni 8

Secili ka të drejtë për mjete juridike efikase para gjykatave kompetente kombëtare për veprimet me të cilat shkelen të drejtat themelore të garantuara nga kushtetuta ose ligjet.

Neni 9

Askush nuk duhet t'i nënshtrohet arbitrarisht arrestimit, ndalimit ose dëbimit.

Neni 10

Secili gëzon një lloj të drejtën për një proces gjyqësor objektiv e publik para një gjykate të pavarur e të paanshme, në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të veta dhe për vendimin mbi çfarëdo lloj akuze penale.

Neni 11

1. Secili që është i akuzuar për një veprë penale ka të drejtë të konsiderohet i pafajshëm deri sa të vërtetohet fajësia në bazë të ligjit dhe në një proces publik në të cilin i ka pasur të gjitha garancitë e duhura për mbrojtjen e vet.
2. Askush nuk duhet të dënohet për veprime ose mosveprime të cilat nuk përbëjnë një veprë penale, sipas ligjeve kombëtare dhe ndërkombëtare në kohën kur janë kryer. Gjithashtu nuk mund të vendoset dënim më i rëndë nga ai që ka qenë zbatuar në kohën kur është kryer vepra penale.

Neni 12

Askush nuk duhet t'i nënshtrohet ndërhyrjes arbitrare në jetën, familjen, banesën ose korrespondencën vetjake, si dhe sulmeve kundër nderit dhe prestigjit personal. Secili ka të drejtë të mbrohet nga ligji kundër ndërhyrjeve ose sulmeve të tilla.

Neni 13

1. Secili ka të drejtë të lirisë së qarkullimit dhe vendbanimit brenda kufijve të çdo shteti.
2. Secili ka të drejtë të largohet nga cilido vend qoftë, përfshirë këtu edhe të vetin, si dhe të kthehet në vendin e vet.

Neni 14

1. Secili ka të drejtë të kërkojë dhe të gëzojë në vende të tjera azil nga ndjekjet.
2. Këtë të drejtë nuk mund ta gëzojë askush në rast se ndiqet për krime jopolitike ose për vepra në kundërshtim me qëllimet dhe parimet e Kombeve të Bashkuara.

Neni 15

1. Secili ka të drejtën e një shtetësie.
2. Askush nuk duhet të privohet arbitrarisht nga shtetësia e tij si dhe as nga e drejta që të ndërrojë shtetësinë.

Neni 16

1. Burrat dhe gratë në moshë madhore kanë të drejtë të lidhin martesë dhe të formojnë familje, pa kurrfarë kufizimi sa i përket racës, shtetësisë ose besimit. Ata kanë të drejta të barabarta si në rastin e lidhjes së martesës, gjatë martesës si dhe në rast shkurorëzimi.
2. Martesa duhet të lidhet vetëm me pëlqimin plotësisht të lirë të personave që do të martohen.
3. Familja është bërthama e natyrshme dhe themelore e shoqërisë dhe ka të drejtën e mbrojtjes nga shoqëria dhe shteti.

Neni 17

1. Secili ka të drejtën të ketë pasuri, si të tij ashtu edhe në bashkëpronësi me të tjerët.
2. Askush nuk duhet të privohet arbitrarisht nga pasuria e tij.

Neni 18

Secili ka të drejtën e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe besimit; kjo e drejtë përfshin lirinë e ndryshimit të besimit ose bindjeve dhe lirinë që njeriu, qoftë vetë ose në bashkësi me të tjerët, të shfaqë publikisht ose privatisht, besimin ose bindjen e vet me anë të dhënies së mësimave, kryerjes së kultit dhe ceremonive fetare.

Neni 19

Secili ka të drejtën e lirisë së mendimit dhe të shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit pa ndërhyrje, si dhe lirinë e kërkimit, marrjes dhe njoftimit të informacionit dhe ideve me çfarëdo mjeti qoftë, pa marrë parasysh kufijtë.

Neni 20

1. Secili ka të drejtën e lirisë së mbledhjes dhe bashkimit paqësor.
2. Askush nuk duhet të detyrohet të bëjë pjesë në ndonjë bashkim.

Neni 21

1. Secili ka të drejtë të marrë pjesë në qeverisjen e vendit të vet, drejtpërdrejt ose me anë të përfaqësuesve të zgjedhur lirisht.
2. Secili ka njëlloj të drejtë të hyjë në shërbimet publike në vendin e vet.
3. Vullneti i popullit është baza e pushtetit shtetëror; ky vullnet duhet të shprehet në zgjedhje periodike dhe të lira të cilat duhet të jenë të përgjithshme dhe votimi i barabartë, si dhe me votim të fshehtë ose sipas procedurës përkatëse të votimit të lirë.

Neni 22

Si anëtar i shoqërisë, secili ka të drejtën e sigurimit shoqëror dhe realizimit të të drejtave ekonomike, sociale, kulturore të domosdoshme për dinjitetin e vet dhe për zhvillimin e lirë të personalitetit, me ndihmën e shtetit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar dhe në përputhje me organizimin dhe mundësitë e çdo shteti.

Neni 23

1. Secili ka të drejtën për punë, të zgjedhë lirisht profesionin, të ketë kushte të volitshme pune dhe të jetë i mbrojtur nga papunësia.
2. Secili, pa kurrfarë diskriminimi, ka të drejtë që për punën e njëjtë të marrë rrogën e njëjtë.
3. Secili që punon ka të drejtë për një shpërblim të drejtë dhe volitshëm, në mënyrë që t'i sigurojë atij dhe familjes së tij një jetë që i përgjigjet dinjitetit njerëzor dhe, në qoftë se do të jetë e nevojshme ky shpërblim të plotësohet edhe me mjete të tjera të sigurimit shoqëror.
4. Secili ka të drejtë të formojë sindikatë dhe të bëjë pjesë në të për mbrojtjen e interesave të veta.

Neni 24

Secili ka të drejtë për pushim dhe kohë të lirë, duke përfshirë kufizimin e arsyeshëm të orarit të punës dhe pushimin e paguar periodik.

Neni 25

1. Secili ka të drejtë për standard që do të sigurojë shëndet dhe mirëqenie për të dhe familjen e tij, duke përfshirë ushqimin, veshjen, strehimin dhe kujdesin mjekësor dhe shërbimet e nevojshme sociale, si edhe të drejtën për të qenë i siguruar në rast sëmundjeje, papunësie, vejani, pleqërie dhe raste të tjera të humbjeve të mjeteve për jetesë për shkak të rrethanave të pavarura nga vullneti i tij.
2. Nënata dhe fëmijët kanë nevojë për kujdes dhe ndihmë të posaçme. Të gjithë fëmijët, të lindur brenda ose jashtë martese, gëzojnë të njëjtat mbrojtje sociale.

Neni 26

1. Secili ka të drejtën e shkollimit. Arsimi duhet të jetë falas, të paktën në shkollat fillore. Arsimi fillor është i detyrueshëm. Arsimi teknik dhe profesional duhet të zgjerohet, kurse arsimit të lartë duhet t'u bëhet i mundshëm të gjithëve në bazë të aftësisë.
2. Arsimi duhet të drejtohet në zhvillimin e plotë të personalitetit të njeriut dhe nga forcimi i respektimit të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore. Ai duhet të nxisë kuptimin, tolerancën dhe miqësinë midis të gjithë popujve, grupeve të racave dhe besimeve, si dhe avancimin e veprimtarisë së Kombeve të Bashkuara për ruajtjen e paqes.
3. Të drejtën për të zgjedhur llojin e arsimit për fëmijët e tyre e kanë në radhë të parë prindërit.

Neni 27

1. Secili ka të drejtë të marrë pjesë lirisht në jetën kulturore të bashkësisë, të gëzojë artet dhe të përfitojë nga përparimi shkencor dhe dobietë e tij.
2. Secili ka të drejtë të mbrojtë interesat morale dhe materiale, që rrjedhin nga çdo krijimtari shkencore, letrare dhe artistike, autor i të cilave është ai vetë.

Neni 28

Secili ka të drejtë për një rend shoqëror dhe ndërkombëtar në të cilin mund të realizohen plotësisht të drejtat dhe liritë e shpallura në këtë Deklaratë.

Neni 29

1. Secili ka detyrime ndaj asaj bashkësie në të cilën është i mundur zhvillimi i lirë dhe i plotë i personalitetit të tij.
2. Në ushtrimin e të drejtave dhe lirive të veta, secili do t'i nënshtrohet vetëm atyre kufizimeve të cilat janë parashikuar me ligj, ekskluzivisht me qëllim që të sigurohet njohja dhe respektimi i nevojshëm i të drejtave dhe lirive të të tjerëve dhe me qëllim që të plotësohen kërkesat e drejta të moralit, rendit publik dhe mirëqenies së përgjithshme në shoqërinë demokratike.
3. Këto të drejta dhe liri nuk mund të zbatohen në asnjë rast kundër qëllimeve dhe parimeve të Kombeve të Bashkuara.

Neni 30

Asgjë në këtë Deklaratë nuk mund të interpretohet si e drejtë e një shteti, grupi apo personi për të kryer çfarëdo veprimtarie ose për të bërë një akt drejtuar kundër çdo të drejte ose lirie të shpallur në këtë Deklaratë.

Aktivitet

Punoni në dyshe dhe përcaktoni nëse thënia e dhënë është i saktë (S) apo i pasaktë (P), duke përdorur Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut. Duke vepruar kështu përpiquni të jepni shembuj specifik që lidhen me thëniet:

1. Të drejtat e njeriut vlejné vetëm për qytetarët e vendeve të pasura.	S	P
2. Refugjatët kanë të njëjtat të drejta njerëzore si qytetarët e tjerë.	S	P
3. Të drejtat e njeriut i takojné çdo qenie njerëzore nga lindja.	S	P
4. Të drejtat e njeriut mund t'u merren njerëzve.	S	P
5. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të gjinisë, racës, etnisë, fesë, moshës, origjinës, aftësisë së kufizuar ose statusit në shoqëri.	S	P
6. Të gjithë njerëzit lindin të lirë dhe me të drejta të barabarta.	S	P
7. Është e arsyeshme që burrat të fitojné më shumë se gratë.	S	P
8. Njerëzit që kanë një mendim tjetër duhet të ndalohen të flasin në televizion.	S	P
9. Vajzat nuk duhet të ndalohen të luajnë futboll sepse janë vajza.	S	P
10. Parimet themelore të të drejtave të njeriut janë universaliteti dhe	S	P

Detyrë:

1. Përmendni situata nga jeta e përditshme kur anëtarët e grupeve të ndryshme trajtoheshin ndryshe edhe pse nuk kishte asnjë arsye të vërtetë për këtë
2. Gjeni cilat nene të Deklaratës sigurojnë: patjetërsueshmërinë, barazinë dhe mosdiskriminimin. Lidhni me jetën e përditshme dhe përshkruani ato.

Luftëtarët e shquar për të drejtat e njeriut

E përmendëm më herët se në të kaluarën njerëzit nuk i kishin lirinë dhe të drejtat e njëjta. Disa guxuan të shprehnin opinionin e tyre publikisht dhe reagues ndaj padrejtësive personale dhe padrejtësive ndaj njerëzve të tjerë.

Roza Luksemburg ishte lindur në shekullin e XIX në Poloni dhe ka pasur një rol të rëndësishëm në historinë politike, por ka pasur edhe një rol të pashmangshëm në idenë e barazisë për burrat dhe gratë. Ajo e shihte veten kryesisht si një person, jo nga këndvështrimi i gjinisë, përkatësisë etnike apo paaftësisë (ajo u sëmur si fëmijë dhe nuk u shërua kurrë plotësisht, kështu që çaloi gjatë gjithë jetës së saj). Ajo pati guximin të hynte në botën e politikës që konsiderohej si sferë mashkullore dhe të luftonte për votë, të paraqiste pikëpamjet dhe idetë e saj dhe të ngrihej në mbrojtje të tyre.



Ajo ishte një person i veçantë me besim të madh. Me veprat e saj ajo u përpoq të inkurajonte gratë e tjera për të ndjekur shembullin e saj. Luksemburgu besonte se gratë mund të arrinin lirinë e plotë vetëm përmes pjesëmarrjes aktive në jetën politike dhe shoqërore.

Martin Luter King - klerik afrikano-amerikan, aktivist i të drejtave civile të shekullit të 20-të dhe fitues i çmimit Nobël për paqe. Ai është një nga figurat më të shquara në historinë e fundit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe konsiderohet si një nga luftëtarët më me ndikim të jodhunës, kurse shumë njerëz në mbarë botën e respektojnë atë si hero, paqebërës dhe martir. Në njohje të rolit të tij të spikatur në historinë amerikane, kryesisht njihet për shkak të rolit të tij në fitimin e të drejtave themelore njerëzore dhe civile të afrikano-amerikanëve. Në vitin 1986 për nder të tij u shpall një festë shtetërore në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, e quajtur Dita e Martin Luter Kingut, e cila festohet të hënën e tretë të janarit çdo vit.

**Hulumto:**

Bëni kërkime mbi jetën dhe veprën e Eleanor Ruzveltit - gruaja që është më përgjegjëse për krijimin e Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut. Më pas paraqisni rezultatin e hulumtimit para të tjerëve.

TË DREJTAT E FËMIJËS

Unë kam të drejtë t'i di të drejtat e mia



Mendo dhe përgjigju:

1. A kanë të drejta të barabarta të gjithë fëmijët në botë?
2. Çfarë të drejtash keni si fëmijë? (Kujtoni Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut.)
3. A duhet të ketë ndonjë të drejtë që dallohet nga të drejtat e të rriturve?



Konventa për të Drejtat e Fëmijës

Fëmijët kanë të njëjtat të drejta si të rriturit (sipas parimit të universalitetit të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut), por janë më të cenueshme se të rriturit (më të ekspozuara ndaj rreziqeve), prandaj mënyra e realizimit të të drejtave të tyre është e ndryshme. Për këtë arsye u miratua Konventa për të Drejtat e Fëmijës, e cila u miratua për të rregulluar specifikat e të drejtave të fëmijëve.

Konventa për të Drejtat e Fëmijës është marrëveshje ndërkombëtare e miratuar nga Kombet e Bashkuara që përmban të drejtat për të cilat shtetet kanë rënë dakord se u takojnë të gjithë fëmijëve në mbarë botën. Konventa përcakton standardet themelore për mirëqenien e fëmijëve në fazat e ndryshme të zhvillimit të tyre.

Vendet që do ta pranojnë këtë Konventë marrin përsipër të krijojnë kushte për realizimin praktik të të drejtave të fëmijëve. Në këtë moment kjo është Konventa që është pranuar nga numri më i madh i vendeve në botë. Rruga për miratimin e këtij dokumenti është e gjatë, por më 20 nëntor të vitit 1989 përfundoi Konventa për të Drejtat e Fëmijës dhe Asambleja e Përgjithshme e miratoi menjëherë. Prandaj 20 Nëntori është Dita e Fëmijëve.



Mendo dhe përgjigju:

Shikoni dhe lexoni kartelat, zgjidhni tre prej tyre dhe jepni një shembull për secilën të drejtë të zgjedhur. Mendoni dhe thoni nëse kartelat që keni zgjedhur përfaqësojnë:

- e drejta që lidhet me mbijetesën e fëmijës,
- e drejta për zhvillimin e fëmijës,
- mbrojtja e fëmijës ose
- e drejta për pjesëmarrje të fëmijës:

Neni 1

E drejta për të qenë
fëmijë deri në moshën
tetëmbëdhjetë vjeç.



Neni 2

E drejta për të respektuar
se kush jam, si jam dhe
nga jam.



Neni 6

E drejta për të jetuar,
rritur dhe zhvilluar.



Neni 9

E drejta për të jetuar me
prindërit e mi.



Neni 15

E drejta për t'u informuar
dhe për të lexuar revista
dhe libra për fëmijë.



Neni 15

E drejta për t'u shoqëruar
lirisht me fëmijët e tjerë.



Neni 19

E drejta për t'u mbrojtur nga
dhuna.



Neni 22

E drejta për t'u
mbrojtur edhe kur nuk
jam në shtëpi ose në
vendbanimin tim.



Neni 24

E drejta për t'u trajtuar
nëse jam i sëmurë.



Neni 27
E drejta për një standard
dhe një jetë që i përshtatet
fëmijës.



Neni 28
E drejta për të shkuar
në shkollë dhe për t'u
arsimuar.



Neni 31
E drejta për lojë, pushim,
kohë të lirë dhe aktivitete
të kohës së lirë.



Neni 32
E drejta për të mos bërë atë që
është e rrezikshme ose që
pengon edukimin dhe zhvillimin
tim.



Neni 33
E drejta për t'u
mbrojtur nga droga.



Neni 34
E drejta për t'u mbrojtur
nga të gjitha format e
shfrytëzimit dhe abuzimit
seksual.



Neni 35
E drejta për t'u mbrojtur nga
rrëmbimi dhe trafikimi i
fëmijëve.



Neni 37
E drejta për t'u mbrojtur nga
tortura, poshtërimi dhe
ndëshkimi.



Neni 42
E drejta për të njohur
të drejtat e mia.



Grupimi themelor i rregullave në lidhje me të drejtat e fëmijës bëhet sipas përmbajtjes:
mbijetesa, mbrojtja, zhvillimi dhe pjesëmarrja.

Të drejtat që lidhen me mbijetesën përfshijnë të drejtat e fëmijëve për jetën dhe nevojat, përmbushja e të cilave është më e nevojshme për ekzistencën. Ato përfshijnë të drejtat e të drejtës për jetë, liri dhe siguri, të drejtën për familje, të drejtën për sigurim shoqëror, të drejtën për kujdes shëndetësor dhe mjekësor.

Të drejtat që kanë të bëjnë me zhvillimin përfshijnë ato gjëra që fëmijët kanë nevojë për të arritur potencialin e tyre. Këto përfshijnë të drejtën për arsimim, të drejtën për arsim cilësor, të drejtën për pushim dhe kohë të lirë, të drejtën për identitetin e dikujt, të drejtën për të përdorur gjuhën e vet.



Të drejtat për mbrojtje imponojnë detyrimin ligjor për të mbrojtur fëmijët nga çdo lloj abuzimi, neglizhim apo shfrytëzim. Këto të drejta përfshijnë çështje të tilla si: e drejta për privatësi, supozimi i pafajësisë derisa të provohet fajësia, mbrojtja nga shfrytëzimi, mbrojtja nga përdorimi i drogave dehëse, mbrojtja nga shfrytëzimi seksual dhe abuzimi seksual, mbrojtja nga abuzimi dhe neglizhenca, ndalimi i skllavërisë.



Të drejtat për pjesëmarrje u mundësojnë fëmijëve të marrin një rol aktiv në shoqëri. Këto përfshijnë të drejtën për të pasur mendim, lirinë e shprehjes dhe qasjen në informacion, lirinë e tubimit dhe e organizimit, lirinë e besimit dhe fesë. Forcimi i aftësive të fëmijëve duhet të çojë në mundësi më të mëdha për pjesëmarrjen e tyre në aktivitetet e shoqërisë, gjë që do t'i përgatisë ata të bëhen qytetarë të rritur të përgjegjshëm.



Pyetje:

1. A i kanë të rriturit këto të drejta apo vlejné vetëm për fëmijët?
2. A kanë fëmijët më pak të drejta se të rriturit?
3. A mund të luftojnë vetë fëmijët për respektimin e të drejtave të tyre?
- 4.



Mendo dhe përgjigju:

Si do t'i zbatoni të drejtat e mëposhtme në shtëpi dhe si në shkollë:

- a) të drejtën për të pasur mendim
- b) të drejtën e privatësisë
- c) e drejta për arsimim
- d) të drejtën për mbrojtje nga dhuna

Të drejtat dhe përgjegjësitë e mia



Mendo dhe përgjigju:

1. Çfarë do të ndodhë nëse dikush keqkupton të drejtën për mendimin e vet?
2. Çfarë do të ndodhë nëse fëmijët fillojnë të ushtrojnë të drejtën e lojës, pushimit, kohës së lirë dhe aktiviteteve të lira gjatë orës së mësimi?

Kur duam të thirremi në një të drejtë, duhet të kemi parasysh se çdo e drejtë përfshin përgjegjësi. Për shembull: e drejta për arsimim përfshin përgjegjësinë për të shkuar rregullisht në shkollë, për të qenë nxënës aktiv dhe i përgjegjshëm; e drejta për të luajtur përfshin përgjegjësinë për të trajtuar me përgjegjësi ndaj rekuizitave e lojës dhe për t'i pastruar ato pas lojës.

Detyrë:

Lidhni të drejtat e fëmijëve me përgjegjësitë përkatëse:

Fëmijët kanë të drejtë të jenë të mbrojtur nga dhuna.



Fëmijët kanë të drejtën e arsimimit.



Fëmijët kanë të drejtën e lirisë së mendimit dhe fesë.



Fëmijët kanë përgjegjësi të mos ofendojnë dhe lëndojnë të tjerët.



Fëmijët kanë përgjegjësinë të respektojnë mendimet dhe bindjet e të tjerëve.



Fëmijët kanë përgjegjësi të mësojnë shumë dhe të ndihmojnë të tjerët të mësojnë.



Fëmijët kanë të drejtë të jenë të dashur dhe të respektuar.



Fëmijët kanë përgjegjësinë për të treguar dashuri dhe respekt ndaj të tjerëve.

Aktivitet

Të drejtat dhe përgjegjësitë

Ndahuni në dy grupe. Grupi i parë do të jenë Aktorë, kurse grupi i dytë do të jenë Vlerësues. Aktorët duhet të zgjedhin një nga të drejtat e fëmijëve dhe të krijojnë një dramë për përgjegjësitë që korrespondojnë me të drejtën që ata i kanë zgjedhur. Vlerësuesit duhet të vlerësojnë nëse Aktorët janë në përputhje ose jo me përgjegjësitë. Nëse ata gjykojnë se Aktorët nuk respektojnë përgjegjësitë, ata bërtasin STOP dhe shpjegojnë se si duhet të zbatohen përgjegjësitë.

Pas dramatizimit diskutoni për lidhjen ndërmjet të drejtave të fëmijëve dhe përgjegjësi të tyre.



Pyetje:

Cilat përgjegjësi i përgjigjen të drejtës:

- a) të mbroresh nga dhuna
- b) të respektosh kush je, si je dhe nga je
- c) e drejta për trajtim



Kur më shkelen të drejtat e mia?

Aktivitet: Debati

Lexoni situatat e mëposhtme, ndahuni në dy grupe dhe argumentoni PËR dhe KUNDËR thënieve të dhëna më poshtë teksteve:

1. Në klasën e Majës erdhi një nxënëse e re. Kur u prezantua, tha se quhej Sun Yu, se ishte e indur në Japoni dhe se këtu do të qëndrojë për një kohë të gjatë për shkak të punës së babait të saj. Ajo ishte e çuditshme për të gjithë sepse dukej pak më ndryshe nga moshatarët e saj. Një grup shokësh të klasës filluan të talleshin me emrin dhe mënyrën e përshëndetjes së saj.



Thënia nr. 1: Shokët e klasës e shkelën të drejtën e fëmijës për të respektuar fëmijën pavarësisht se kush është, si është dhe nga është.

Thënia nr. 2: Shokët e klasës kishin të drejtë të shkelnin të drejtën e fëmijës sepse fliste dhe sillej Vërtet në mënyrë të çuditshme.

2. Nxënësit e klasës së pestë mësuan për të drejtat e fëmijëve. Mësuesja u tha atyre se ka vendet disa shtete ku fëmijët nuk mund të arsimohen dhe se ata punojnë në fabrika, miniera, fusha. Njëkohësisht një nxënës tha se ndoshta ata fëmijë nuk mësojnë, prandaj shkojnë në punë. Një nxënëstjetër kundërshtoi dhe tha se atyre fëmijëve iu shkelet e drejta për arsimim, por edhe se atadetyrohen të punojnë.

Thënia nr. 1: Fëmijëve që nuk mund të arsimohen u shkel et e drejta për arsim.

Thënia nr. 2: Nxënësi kishte të drejtë që fëmijët nuk mësohen, ndaj shkojnë në punë.

Thënia nr. 3: Nxënësi kishte të drejtë që ata fëmijë detyrohen të punojnë.



Detyrë:

Në tabelën e mëposhtme jepen disa të drejta të fëmijëve. Në kolonën e zbrazët shkruani se në çfarë mënyre mund të shkelen të drejtat:

Të drejtat e fëmijëve	Mënyra e shkeljes së të drejtave
1. Fëmija ka të drejtë të lirisë së mendimit dhe e fesë	
2. Fëmija ka të drejtë të mos bëjë atë që pengon edukimin dhe zhvillimin e tij	
3. Fëmija ka të drejtën e lirisë së mendimit dhe fesë	
4. Fëmija ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga dhuna	

A e dini se...

Ambasada e parë e fëmijëve në botë quhet **Megjasi** dhe është themeluar më 29 prill të vitit 1992 në Shkup si shoqatë botërore dhe organizata e parë e regjistruar ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Ajo me aktivitetet e saj ka kontribuar në ngritjen e vetëdijes së qytetarëve për të drejtat e fëmijëve.



UNICEF është Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët që punon për të shpëtuar jetët e fëmijëve, për të mbrojtur të drejtat e fëmijëve dhe për të realizuar potencialin e fëmijëve.

Rezultatet e mësimi

Nxënësi do të aftësohet:

- të shpjegojë sesi zbulimet e mëdha gjeografike kontribuan në përhapjen e popullsisë nga një kontinent në tjetrin;
- të rregullojë kontinentet sipas madhësisë së sipërfaqes, sipas numrit të popullsisë dhe dendësisë së popullimit dhe të bëjë dallimin ndërmjet kontinentit me popullsinë më të dendur dhe kontinentit me popullsinë më të madhe;
- të bëjë dallimin midis shkallës së lindjeve, shkallës së vdekshmërisë dhe rritjes natyrore të popullsisë;
- të shpjegojë strukturën dhe lëvizjen e popullsisë në botë;
- të tregojë vendet më të mëdha në çdo kontinent (sipas sipërfaqes dhe popullsisë) dhe kryeqytetet e tyre dhe t'i tregojë ato në një hartë;
- të përshkruajë Republikën e Maqedonisë së Veriut sipas vendpozitës së saj (në Evropë dhe Gadishulli Ballkanik), sipërfaqes, numrit të popullsisë dhe dendësisë së popullimit.

POPULLSIA DHE KONTINENTET

ZGJERIMI I POPULLSISË NË TOKË

- Kur dhe ku u shfaqën njerëzit e parë?
- Llojet/tipat e popullsisë në Tokë

ZBULIMET E MËDHA GJEOGRAFIKE

POPULLSIA BOTËRORE

- Sipërfaqja, numri i popullsisë dhe dendësia e popullimit
- Popullsia/rritja natyrore
- Migrimi i popullsisë

VENDET MË TË MËDHA NË BOTË

- Shtetet më të mëdha të kontinenteve
- Fakte për shtetet më të mëdha

POPULLSIA, SIPËRFAQJA DHE VENDPOZITA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

ZGJERIMI I POPULLSISË NË TOKË


Ku dhe kur u shfaqën njerëzit e parë?

Në grafik është dhënë numri i banorëve të planetit tonë nga e kaluara e largët e njeriut deri në ditët e sotme.



Mendo dhe përgjigju:

1. Kur ka qenë popullsia më e vogël dhe kur ka qenë popullsia më e madhe?
2. Pse kishte më pak popullsi në planetin tonë në të kaluarën?



Njeriu u shfaq relativisht vonë në planetin Tokë. Paraardhësit tanë njerëzorë ndoshta kanë evoluar nga krijesa të ngjashme me shimpanzot më shumë se 10 milionë vjet më parë. Paraardhësit tanë njerëzorë jetonin në rajone më të ngrohta të pasura me ujë dhe ushqim. Sipas hulumtimeve të fundit, në Afrikë është zbuluar një kafkë rreth 7 milionë vjeçare.

Ne e quajmë paraardhësin më të vjetër të njeriut **paraardhës**. Ai për herë të parë u shfaq në Afrikën Lindore. Në pamjen e tij ai ishte shumë i ndryshëm nga njerëzit e sotëm. Ai ishte i përkulur, i mbushur me flokë dhe koka e tij ishte më e vogël. Për të mbijetuar në natyrë dhe për të jetuar, njeriu primitiv duhej të mendonte, domethënë të përdorte arsyen e tij. Kështu, u nda njeriu nga kafshët.

Si u zhvillua dhe u përhap popullsia e vendit?

Njerëzit e parë ishin të paktë dhe të kërcënuar nga pjesa tjetër e kafshëve të egra, veçanërisht mishngrënësit. Njerëzit ishin ndër më të dobëtit, nuk mund të lëviznin shpejt, nuk kishin dhëmbë të mëdhenj, nuk kishin kthetra dhe ishin të vegjël që kishin nevojë për ushqim dhe mbrojtje të rregullt afatgjatë. Në kushte të tilla pasigurie dhe pafuqie ekstreme, ata kishin edhe një përparësi të caktuar në krahasim me kafshët e tjera, që ishte fuqia për të menduar, përshtatur, jetuar në grup, bashkëpunim, kërkim ushqimi dhe gjueti së bashku.

Lufta për ekzistencë dhe mbijetesë i detyroi njerëzit të ngriheshin në këmbë, të komuniknin me njëri-tjetrin, të zhvillonin fjalën dhe të krijonin komunitete. Me kalimin e viteve ata filluan të lëviznin dhe të kërkonin një vend më të bukur për të jetuar.




Mendo dhe përgjigju:

Pse fjalimi ishte një nga arritjet më të rëndësishme të njeriut?

Hulumto

Hulumto nëse paraardhësit dhe dinosaurët kanë jetuar në të njëjtën periudhë gjatë evolucionit të tyre? Në hulumtimi tënd mund të kërkosh të dhëna në internet, enciklopedi, muze ose burime të tjera.

**A e keni ditur se**

Fjala **evolucion** nënkupton ndryshimin gradual dhe të ngadaltë të organizmave të gjallë nga brezi në brez.



Figura: Rindërtimi i njeriut "të aftë" dhe "të drejtë".

Aktivitet

Në YouTube gjeni videon e titulluar "Nome Planet - Human Migration" dhe zbuloni se si ka ndodhur vendosja e territoreve në parahistori.

Zhvillimi dhe zgjerimi i popullsisë në sipërfaqen e Tokës varet nga faktorët natyroro-geografikë, edhe atë nga:

- relievi,
- klima,
- hidrografia,
- burimet natyrore (mineralet, burimet e energjisë, bota bimore dhe shtazore).

Ky ndikim i faktorëve natyrorë ishte vendimtar në zhvillimin dhe përhapjen hapësinore të njeriut në Tokë.



Drejtimi i migrimit të paraardhësve

Ndërgjegjësimi i botës rreth tij dhe zbulimi i sipërfaqeve të reja tokësore me kalimin e kohës kontribuan për njerëzit që banonin në të gjitha kontinentet.



Pyetje:


1. Ku u gjetën mbetjet më të vjetra të njeriut të parë primitiv?
2. Cilat shenja të evolucionit e dallojnë njeriun e parë nga kafshët e tjera?
3. Në çfarë mënyre mbijetoi njeriu primitiv në kushtet e vështira të jetesës?
4. Cila ishte arsyeja e vendosjes në vende të reja?
5. Në cilat drejtime ka ndodhur shpërngulja e njerëzve në të kaluarën e largët?
6. Në çfarë mënyre relievi, klima, hidrografia dhe burimet natyrore kanë ndikuar dhe ndikojnë në zhvillimin dhe zgjerimin e popullsisë në sipërfaqen e Tokës?

Llojet/tipat e popullsisë së vendit




Mendo dhe përgjigju:

1. Krahsoji hartat e vendbanimeve në botë dhe përgjigju:
 - Në cilën periudhë kohore ekziston popullsia më e madhe në sipërfaqen e Tokës?
 - Çfarë ka ndikuar në ndryshimin e popullsisë së planetit tonë?



Vendbanimet e përhershme në parahistori



Vendbanimet e përhershme në kohët moderne (Evropa dhe një pjesë e Azisë) (burimi: <https://bioone.org/journals/journal-of-resources-and-ecology>)

Tashmë kemi përmendur se relievi, klima, hidrografia dhe burimet natyrore ndikojnë në dendësinë e popullsisë njerëzore dhe aktivitetin e tij ekonomik.

Përhapja e popullsisë njerëzore që nga migrimet e para deri në ditët e sotme ka ndryshuar dhe është përmirësuar vazhdimisht në bazë të cilësisë. Sipas hulumtimeve, popullsia e një hapësirë të caktuar më së shumti varet nga karakteristikat natyrore-geografike të hapësirës dhe në bazë të kësaj dallohen tre lloje të popullsisë, edhe atë: hapësirë e banuar përherë, hapësirë e pabanuar dhe hapësirë e banuar përkohësisht.

Nëse vëzhgojmë hapësirën e banuar vazhdimisht në sipërfaqen e Tokës që nga shfaqja e njerëzve të parë e deri në ditët e sotme, do të vërejmë dallime të mëdha. Në të kaluarën e largët hapësirë e përhershme e populluar e Tokës ishte shumë më e vogël se sot. Në veçanti, ajo filloi të rritet me zbulimet e mëdha geografike dhe zbulimin e kontinenteve të Amerikës dhe Australisë. Hapësira e banuar përgjithmonë përbëhet nga qytetet dhe fshatrat e sipërfaqes së Tokës.

A e keni ditur se

Qyteti më i madh me banorë në botë është Tokio (Japoni) me 37.3 milionë banorë.

Qyteti më i madh në botë për nga sipërfaqja është Nju-Jorku (SHBA) me një sipërfaqe prej 11,642 km².



Tokio



Nju-Jork


Ekziston edhe një pjesë e sipërfaqes së Tokës që **nuk është fare e banuar**. Fjala është për pjesët e larta malore në lartësi mbi 6000 metra, pra mbi vijën e borës, hapësirat e mëdha të shkretëtirës ranore dhe gurore, kënetat e pakalueshme, komplekset e dendura pyjore dhe të pakalueshme të pyjeve ekuatoriale, tropikale e të tjera, me borë. hapësirat e rajoneve polare e të ngjashme.



Figura: Rajonet e pabanuara të Tokës

A e keni ditur se

Shkretëtira Danakil në Etiopinë verilindore konsiderohet si një nga vendet më të nxehta në planet. Temperatura arrin deri në +70 gradë Celsius. Në territorin e saj ka vullkane aktive dhe të fjetura, për shkak të të cilave ka avuj sqqfuri në ajër, kurse këtu gjendet edhe liqeni i kripur, i cili ndodhet në lartësinë më të ulët në botë. Për shkak të karakteristikave të përmendura, ky vend nuk ka kushte për banim dhe nuk është i banuar.



Sipërfaqet e Tokës që **banohen herë** pas here nga njerëz për të plotësuar disa nevoja janë mjaft të mëdha. Ato janë të një natyre të përkohshme ose sezonale, ku qëndrimi i njeriut ka për qëllim përmbushjen e qëllimeve të tij shëndetësore, rekreative ose ekonomike. Hapësirat e banuara të përkohshme mund të jenë hapësira me vendbanime vikendi, qendra rekreative, shtëpiza malore, gjuetie dhe peshkimi.

Kështu, malet, veçanërisht në periudhat e ngrohta të vitit, janë të përshtatshme për vendbanimin e blegtorëve që e kullosin bagëtinë e tyre, ndërtojnë vendbanime të përkohshme - bulmetore, kasolle etj., por edhe për turistët (alpinistët) sezonalë që qëndrojnë përkohësisht në pjesët e larta të maleve (në shtëpi malore, strehimore, kampe të përkohshme çadrash etj.). Peshkimi sezonal në vendet më të largëta - dete dhe oqeanë të hapura, i detyron peshkatarët në disa brigje bregdetare ose në ishuj të vetmuar dhe të pabanuar të ndërtojnë banesa të përkohshme dhe vendbanime peshkimi.



Hulumto

Si dhe pse eskimët ndërtojnë banesa të përkohshme?

Mëso më shumë

Të tre llojet e popullsisë në një zonë të caktuar kanë emrat e tyre: ekumena - hapësirë e banuar përgjithmonë, anekumena - hapësirë e pabanuar dhe subekumena - hapësirë e banuar përkohësisht.

Aktivitet:

Ndahuni në tre grupe. Grupi i parë le të shkruajë karakteristika pozitive dhe negative të hapësirave të banuara përgjithmonë, grupi i dytë karakteristika të hapësirave të pabanuara dhe grupi i tretë karakteristika të hapësirave të banuara përkohësisht. Regjistroni vëzhgimet në tabelë. Vini re cilat janë anët e përbashkëta pozitive dhe cilat janë anët e përbashkëta negative të hapësirave të banuara përgjithmonë, të pabanuara dhe të banuara përkohësisht.

Diskutoni në lidhje me pyetjen: Cilat hapësira të banuara përkohësisht mund të bëhen hapësira të banuara përgjithmonë? Çfarë duhet të bëjë njeriu që kjo të ndodhë?

HAPËSIRAT E BANUARA PËRGJITHMONË

ANËT POZITIVE	ANËT NEGATIVE

HAPËSIRAT E BANUARA PËRKOHËSISHT

ANËT POZITIVE	ANËT NEGATIVE

HAPËSIRAT E PABANUARA

ANËT POZITIVE	ANËT NEGATIVE

Debat:

Debat në lidhje me pyetjen: Hapësirat e banuara përkohësisht njeriu a duhet t'i shndërrojë në hapësirë të banuar përgjithmonë? Zgjidhni argumentet tuaja për qëndrimin që keni.

**Pyetje:**

1. Nga se varet popullsia e territoreve të caktuara në sipërfaqen e Tokës?
2. Cila pjesë e botës ka popullsi më të madhe?
3. Pse disa territore janë të populluara përgjithmonë, kurse disa janë të pabanuara?
4. Cilat kushte duhet të ekzistojnë që njerëzit të banojnë në një territor?

ZBULIMET E MADHE GJEOGRAFIKE

Zhvillimi i shpejtë i shoqërisë e shtoi edhe kureshtjen e njerëzve për të zbuluar vende të reja dhe për të kuptuar botën. Në mesjetë vendet e pasura lindore, India dhe Kina, ishin burimi kryesor i furnizimit të Evropës me erëza dhe mirudi të ndryshme, ar, gurë të çmuar, mëndafsh etj. Me pushtimin e osmanëve në Evropë tregtarëve evropianë iu ndërpre në të gjitha rrugët tokësore. Prandaj, ata u detyruan të zbulonin rrugë detare, të cilat do t'i ndihmonin të arrinin në vendet e dëshiruara. Në këto synime i ndihmuan shpikjet e reja teknike, si harta, busulla, armët e zjarrit, baroti dhe anija e re, e quajtur karavelë, e cila ishte më rezistente, lehtësisht e lëvizshme dhe mund të strehonte më shumë detarë. Aventura mund të fillojë. Udhëtimet e para u ndërmorën nga marinarët spanjollë dhe portugezë. Por, ndodhi diçka e papritur. Në vend të rrugës detare për në Indi, u zbulua një kontinent i ri.




A e keni ditur se

Popullsia vendase në Amerikë gabimisht e mori emrin Indianë? Se si ndodhi kjo do ta mësoni në tekstin vijues.



Kristofor Kolumbo, kur u largua nga Spanja në vitin 1492 me tri karavella të quajtura "Shën Mëria", "Ninja" dhe "Pinta", arritën në ishullin e San Salvadorit për pak muaj. Kolumbo ishte i bindur se kishte zbuluar rrugën detare për në Indi, prandaj i quajti njerëzit atje indianë. Më vonë lundërtari Amerigo Vespuçi vërtetoi se zbulimi i Kolumbos nuk ka të bëjë me Indinë, por një kontinent të ri, i cili u emërua pas tij Amerika.



Harta e udhëtimeve të Kristofor Kolumbos

Mendo

Nëse do të jetonim në shekullin X, a mund të bënim patate të skuqura?

A e keni ditur se

Gjatë gjithë historisë, erëzat janë përdorur si ilaçe, kozmetikë, parfume. Në mesjetën e lashtë dhe të mesme erëzat ishin produkt i rrallë dhe i shtrenjtë në treg. Ato mund t'i kishin vetëm më të pasurit. Erëzat si pipëri, kanelli, karafili, arrë deti importoheshin nga India, Kina, Arabia dhe ishin më të shtrenjta se ari.

Zbulimi i Vasko de Gamës kontribuoi në uljen e çmimit të erëzave në mesjetë.



Vasko de Gama



Harta e udhëtimeve të Vasko de Gamës

Vasko de Gama ishte lundërtari i cili në vitin 1498 i shkoi rreth e përqark Afrikës dhe arriti në bregun indian. Ai zbuloi rrugën detare për në Indi.


**Mendo dhe përgjigju:**

Si kontribuoi zbulimi i rrugës detare për në Indi në uljen e çmimit të erëzave dhe produkteve të tjera të vlefshme në mesjetë?

A e keni ditur se

Emri i Oqeanit Paqësor u dha nga Fernando Magelani i cili, në lundrimin e tij përgjatë tij, mendoi se oqeani ishte i qetë, i paqësor. Ai është lundërtari i parë që vendosi lidhjen midis Oqeanit Paqësor dhe Atlantikut.

Fernando Magelani ishte lundërtar portugez i cili është shumë i rëndësishëm sepse arriti të vërtetojë se Toka ka një formë të rrumbullakët. Ai e filloi udhëtimin e tij në vitin 1519 kur lundroi nga Evropa në Azi duke shkuar në perëndim dhe kështu arriti të përgënjeshtrojë mendimin e njerëzve se Toka është e rrafshët. Ajo që është interesante është frika e marinarëve të Magelanit. Shumica prej tyre menduan se do të vinin në fund të Tokës dhe do ta binin nga buza e tij. Ky mendim i mbushi me frikë të pabesueshme.




Disa shekuj më vonë, i njohuri **Xhems Kuk**, si kapiten i Marinës Mbretërore, bëri tre udhëtime në Oqeanin Paqësor, gjatë të cilave ai ishte evropiani i parë që u ankorua në bregun lindor të Australisë, në Kaledoninë e Re, Ishujt Sandviç të Jugut dhe Havaje. Ai ishte gjithashtu lundërtari i parë që bëri rreth Antarktidës dhe hartoi hartën e Njufaulndit dhe Zelandës së Re.



Zbulimet e mëdha gjeografike kontribuan në zhvillimin më të shpejtë të qyteteve, të cilat u bënë qendra të mëdha tregtare. Tregtarët evropianë nga territoret e sapo zbuluara sollën ar, argjend, erëza e të tjera. Filloi vendosja e Amerikës, pastaj Australisë dhe Zelandës së Re.

Nga Amerika në Evropë u sollën kultura të reja bujqësore, të panjohura më parë: patate, misër, duhan, kakao e të tjera. Në Amerikë filluan të rriten pambuku, hardhia, lloje të ndryshme frutash, disa lloje kafshësh e të tjera.



Hulumto

Ndahuni në grupe dhe hulumtoni lundruesit dhe shpikësit e lartpërmendur. Përgatitni prezantime dhe prezantoni rezultatet e hulumtimit.



Pyetje:

1. Cila ishte arsyeja e organizimit të udhëtimeve detare nga vendet e pasura evropiane?
2. Cili ishte qëllimi i udhëtimit të Kristofor Kolumbos?
3. Si e vërtetoi Fernando Magelani se Toka është e rrumbullakët?
4. Pse është i rëndësishëm zbulimi i rrugës detare për në Indi nga Vasko de Gama?
5. Si ndikuan zbulimet e mëdha gjeografike në zhvillimin e mëtejshëm të botës?

POPULLSIA BOTËRORE

Sipërfaqja, numri i popullsisë dhe dendësia e popullimit

Rikujtohu:

- Si quhen kontinentet e Tokës?
- Numëroji oqeanet e Tokës!

A e dini se të gjitha detet dhe oqeanet janë të lidhura me njëri-tjetrin, duke përbërë Detin e madh Botëror? Sipërfaqet më të mëdha tokësore që janë të rrethuara nga të gjitha anët nga ujërat e Detit Botëror quhen kontinente. Sipërfaqja e madhe e ujit zë dy të tretat, kurse toka zë një të tretën e sipërfaqes së Tokës.



Paraqitja e Detit Botëror dhe kontinenteve

Në sipërfaqen e Tokës ka shtatë kontinente: Evropa, Azia, Afrika, Amerika e Veriut, Amerika e Jugut, Australia me Oqeaninë dhe Antarktida. Kontinenti më i madh është Azia, kurse më i vogli është Australia. Sipërfaqja e përgjithshme e të gjitha kontinenteve është 139 milion km^2 , 10 milion km^2 të tjera të tokës është sipërfaqja e ishujve.

**Mendo dhe përgjigj:**

Shikoni hartën dhe vëreni se cila hemisferë (veriore apo jugore) ka më shumë tokë dhe cila ka më shumë ujë?



Pjesa më e madhe e tokës shtrihet në hemisferën veriore: Evropë, Azi, Amerikën e Veriut dhe gjysmën e Afrikës. Në hemisferën veriore, sipërfaqet ujore zënë 61% dhe kontinentet 39%.

Në hemisferën jugore shtrihen: pjesa jugore e Afrikës, Amerika e Jugut, Australia, Antarktida dhe një numër ishujsh në Oqeani. Sipërfaqet ujore zënë 81%, kurse 19% është tokë.

Evropa dhe Azia përfaqësojnë një tërësi. Është toka e madhe euroaziatike me një sipërfaqe prej 54 milionë km². Kufiri imagjinar midis Evropës dhe Azisë është përgjatë rrjedhës së lumit Ural dhe maleve Ural, Liqenit Kaspik, Kaukazit dhe Detit të Zi.


Kontinentet, përveç Evropës dhe Azisë, ndahen nga njëri-tjetri me oqeanë, dete dhe lumenj.

Sipërfaqja e zënë nga kontinentet, numri i popullsisë dhe dendësia e popullimit janë karakteristika të ndryshme për të gjitha kontinentet.




Numri i popullsisë tregon se sa banorë ka në kontinent. Kështu, kontinenti më i madh për nga numri i banorëve është Azia, ku jeton rreth 60% e popullsisë së botës, kurse më i vogli është Antarktida, e cila nuk ka banorë të përhershëm, por vetëm rreth 1000 deri në 4000 banorë të përkohshëm.

Dendësia e popullimit është masa e numrit të njerëzve për njësi sipërfaqeje, zakonisht e shprehur si numri i njerëzve për një kilometër katror. Dendësia mesatare e popullimit merret kur numri i banorëve të atij kontinenti pjesëtohet me sipërfaqen e kontinentit. Kështu, Azia ka popullsinë më të dendur me 93,41 banorë për 1 km², kurse më e vogla është Antarktida me 0 banorë të përhershëm për 1 km².



Shpërndarja e kontinenteve të Tokës

A kemi arritur në përfundimin se cili është kontinenti më i madh në Tokë? Sigurisht, është Azia. Është më i madhi si për nga madhësia ashtu edhe për nga popullsia. Por, çfarë është me shtatë kontinentet e tjera: Afrika, Antarktida, Australia, Evropa, Amerika e Veriut dhe Amerika e Jugut? Mësoni se si renditen këto kontinente sipas sipërfaqes, numrit të banorëve dhe dendësisë së popullimit dhe zbulojnë fakte argëtuese për secilin prej tyre.



Detyrë:

Duke përdorur grafikun shtyllor, renditni kontinentet sipas sipërfaqes që zënë, duke filluar nga më madhi. Diskutoni se cili kontinent është më i madhi dhe cili është më i vogli sipas sipërfaqes që zë. Sa kilometra katrorë është diferenca midis kontinentit më të madh dhe më të vogël?

Kontinentet e renditura sipas **numrit të banorëve**:



Përveç kësaj, ka më shumë se 15 milionë njerëz që nuk jetojnë në një kontinent. Pothuajse të gjithë këta njerëz jetojnë në vendet ishullore të Oqeanisë, rajon botëror, por jo kontinent.

Kontinentet e renditura sipas **dendësisë së popullimit**:

Numri i banorëve në 1 km²



(të dhëna nga viti 2022)



Mendo dhe përgjigju:

1. Çfarë mund të përfundoni nga të dhënat e paraqitura:

- A varet numri i banorëve nga madhësia e sipërfaqes së një kontinenti?
- A varet dendësia e popullimit nga numri i banorëve të kontinentit?
- Tregoni një shembull ku numri i banorëve nuk varet nga hapësira që zë kontinentin!



A e keni ditur se

- **Azia** ka pikat më të larta dhe më të ulëta në Tokë. Mont Everesti është pika më e lartë në Tokë me 29.035 metra mbi nivelin e detit. Pika më e ulët është Deti i Vdekur, i cili është më shumë se 1400 metra nën nivelin e detit.
- **Afrika** është vendi i lumit më të gjatë në botë, Nilit. Shtrihet 6650 km nga Sudani deri në Detin Mesdhe.
- **Amerika e Veriut** krenohet me liqenin më të madh të ujërave të ëmbla në botë, Liqenin Superior. Një nga Liqenet e Mëdha, Liqeni Superior, zë një sipërfaqe prej 82,103 km² dhe ndodhet midis Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Kanadasë.
- **Amerika e Jugut** ka vargmalin më të gjatë malor në botë. Malet e Andeve shtrihen 7000 km nga Venezuela në jug deri në Kil.
- **Australia** është kontinenti më i vogël dhe i vetmi në botë që përbëhet nga vetëm një shtet.
- **Antarktida** është e mbuluar me më shumë akull se çdo kontinent tjetër. Pothuajse 98 për qind e këtij kontinenti jugor është i lidhur me akull.

**Pyetje:**

1. Cilat kontinente nuk ndahen me lumenj, dete apo oqeanë?
2. Cili është kontinenti më i madh dhe cili është më i vogël sipas sipërfaqes?
3. Cili është kontinenti më i vogël për nga popullsia?
4. Renditi kontinentet sipas dendësisë së popullimit duke filluar nga më i vogli.
5. Shpjego pse numri i banorëve nuk varet nga madhësia e sipërfaqes së kontinentit.



Popullsia/rritja natyrore



Mendo dhe përgjigju:

- A është konstant numri i banorëve të planetit tonë?
- Nga çfarë varet ndryshimi i numrit të banorëve?

Nataliteti tregon numrin e lindjeve të fëmijëve të gjallë në një periudhë të caktuar kohore dhe është një komponent themelor i lëvizjes natyrore të popullsisë.

Shkalla e lindjeve me kalimin e kohës ka qenë e ndryshme në kontinente të ndryshme. Ajo në botë ndryshoi me kalimin e kohës, në varësi të periudhës, kushteve natyrore, faktorëve shoqërorë, socialë dhe ekonomikë. Nataliteti (shkalla e lindjeve) është e ndryshueshme nga pikëpamja hapësinore dhe kohore dhe ndryshon në kontinente, rajone dhe shtete.

Vdekshmëria përfaqëson numrin e njerëzve që vdesin në një popullsi për një periudhë të caktuar kohore. Vdekshmëria është pjesë e lëvizjes natyrore të popullsisë që i referohet vdekshmërisë. Niveli i vdekshmërisë varet nga disa faktorë, edhe atë: faktorët biologjikë, struktura moshore e popullsisë, faktorët natyrorë, faktorët politikë, rrethanat sociale në shtete, kushtet shëndetësore, standardi i jetesës e të tjera.

Shkalla e vdekshmërisë me kalimin e kohës ndryshon gjithashtu sipas kontinentit.



Rritja natyrore është ndryshimi midis lindjes dhe vdekjes në një popullsi. Shtimi natyror tregon rritje ose ulje të numrit të popullsisë. A do të rritet apo do të ulet varet nga lindshmëria dhe vdekshmëria.

Shkalla botërore e shtimit natyror shënon rënie gjatë 30 viteve të fundit në të gjitha kontinentet, përveç Afrikës.

Detyrë:

Në linkun e dhënë mund të shikosh se si lëviz lindshmëria dhe vdekshmëria në nivel botëror:
<https://www.worldometers.info/>

Në të kaluarën faktorët natyroro-gjeografikë kanë pasur ndikim veçanërisht të madh në lëvizjen natyrore të popullsisë. Ndryshimet klimatike dhe kushtet e pavoritshme natyrore të motit, katastrofat dhe fatkeqësitë: erupsione, tërmete, përmytje, epidemi, cunami, uragane, tornado, rrëshqitje të tokës e të tjera, shkaktuan ulje të numrit të popullsisë përmes rritjes së vdekshmërisë. Për shembull: erupsioni i Krakatoas në vitin 1883 shkaktoi 40.000 viktima; tërmeti në Tokio në vitin 1928 mori 140.000 viktima; epidemia e murtajës në Evropë në shekullin e 14-të mori 25 milionë viktima.



image: Pasojat nga cunami:



figura: Pasojat nga tërmeti

Në lëvizjen natyrore të popullsisë kanë ndikim të madh faktorët shoqëroro-ekonomikë, politikë dhe socialë, si: konfliktet ushtarake në mbarë botën, standardi i jetesës, varfëria, uria etj. Edhe sot këta faktorë janë shkak i rritjes së vdekshmërisë, por edhe i migrimit të popullsisë.

Hulumto

Hulumtoni pasojat e tërmetit të Shkupit në vitin 1963 dhe përmytjes së madhe në Stajkovc në vitin 2016.

Detyrë:

Flisni për pasojat e shkaktuara në mbarë botën nga pandemia COVID-19, të cilën edhe ju jeni dëshmitarë.



Pyetje:

1. Nga cilët faktorë varet lindshmëria dhe nga cilët faktorë varet vdekshmëria?
2. Çfarë është shtimi natyror?
3. Në cilat raste ka ndryshim të shtimit natyror në ndonjë vend, rajon, kontinent?

Migrimi i popullsisë

Rikujtohu:

- Në çfarë drejtimesh ka ndodhur vendosja e territoreve të reja në parahistori?



Mendo dhe përgjigju:

- A njihni njerëz që janë shpërngulur ose janë larguar nga vendbanimi juaj?
- Ku janë zhvendosur ose nga janë shpërngulur ata njerëz?
- Cila ishte arsyeja e shpërnguljes apo largimit nga vendbanimi?

Migrimi është lëvizja e popullsisë nga një vend në tjetrin. Arsyet e migrimit mund të jenë nga:

- arsye ekonomike,
- arsye politike,
- arsye fetare,
- fatkeqësitë natyrore,
- arsye shëndetësore etj.

Migramet janë në këtë formë:

Emigracioni - është largimi, emigrimi i njerëzve rajoni ose lokaliteti i tyre nga vijnë, për t'u vendosur në një vend, rajon ose lokalitet tjetër që u ofron perspektivë më të mëdha sa i përket të ardhurave ekonomike, cilësisë së jetesës dhe mundësive për zhvillimin e jetës së tyre personale dhe familjare.

Imigrimi - vendosja në një vend, rajon ose qytet nga një individ ose një grup njerëzish nga një vend, rajon ose qytet tjetër, me mundësinë për të vendosur për një cilësi më të mirë jetese, mundësi më të mira, të ardhura më të larta ekonomike dhe mundësi për zhvillim personal dhe familjar.

Migramet mund të jenë të brendshme, kur ndodhin brenda një vendi dhe të jashtme, kur ndodhin jashtë kufijve të vendit.



Në periudha të veçanta kohore në vendin tonë ndodhën migrime të mëdha të brendshme në drejtimin fshat-qytet, veçanërisht në drejtim të qytetit të Shkupit (si nga vendbanimet rurale ashtu edhe ato urbane). Vala më intensive e këtij lloji të migrimit ndodhi gjatë periudhës së industrializimit të vendit (vitet e gjashtëdhjeta dhe shtatëdhjetë të shekullit të kaluar). Vlerësohet se gjatë kësaj periudhe më shumë se 175.000 njerëz u larguan nga mjediset rurale për të kërkuar jetesën e tyre në vendbanimet urbane.

Një rrjedhë e tillë migrimi shkaktoi mbipopullim në vendbanimet urbane (sidomos në qytetin e Shkupit) dhe pasoja të konsiderueshme në strukturën moshore të popullsisë.

Por, gjithashtu edhe një numër i madh i banorëve të vendit tonë në shekullin e kaluar emigruan drejt vendeve ekonomikisht më të zhvilluara të Evropës, por edhe në kontinente të tjera. Edhe në botë migrimet janë arsyeja e ndryshimit të numrit të popullsisë dhe dendësisë së popullimit në një territor. Kështu, me zbulimin e kontinenteve të reja dhe rrugëve të reja detare, popullsia e rajoneve të caktuara ndryshoi, por rrjedhimisht edhe numri dhe dendësia e popullimit. Amerika dhe Australia u populluan me një popullsi të re nga Evropa dhe në ato kontinente filluan të krijohen shtete të reja.

Në kohën e re, moderne, me zhvillimin e vullshëm të teknologjisë, mjeteve e komunikimit dhe trafikut, lëvizja migratore e popullsisë bëhet më e shpeshtë dhe më e lehtë.

Migrimi i tillë mundëson komunikim më të madh mes njerëzve dhe kontribuon në pranimin e dallimeve racore, fetare dhe gjuhësore ndërmjet njerëzve.



Hulumto

Hulumtoni migrimet e fundit. Cilat janë arsyet?

Çfarë pasojash shkaktojnë migrimet për një territor të caktuar? Cilat janë përfitimet për botën prej tyre, sa i përket komunikimit midis njerëzve që u përkasin racave, feve, kombeve të ndryshme?



Pyetje:

1. Cilat janë arsyet e migrimit?
2. Jepni një shembull të migrimit të brendshëm nga mjedisi juaj i afërt.
3. Çfarë pasojash ka migrimi në shoqëri?

SHTETET MË TË MËDHA NË BOTË

Shtetet më të mëdha në kontinente



Mendo dhe përgjigju:

- Shikoni hartën politike të botës dhe vlerësoni se në cilin kontinent cili shtet është më i madhi sipas sipërfaqes që zë.



Mendo:

- A varet numri i banorëve nga madhësia e sipërfaqes së shtetit?

Duke përshkuar globin, vendet më të mëdha të botës ofrojnë një larmi gjeografike, klime, kafshë të egra, kulturë dhe popuj që jetojnë në to. Në botë ekzistojnë 195 shtete sovrane, por ekzistojnë edhe vende që janë të varura nga vende të tjera ose vende me teritore kontestuese.

Detyrë:

Në tabelën e mëposhtme janë renditur shtetet më të mëdha në botë sipas karakteristikës specifike. Duke analizuar dhe krahasuar të dhënat në tabelë, do të arrini në shumë njohuri interesante dhe do të nxirrni përfundime të dobishme.

1. Fillimisht, plotësoni kolonën e fundit dhe shkruani në fushat e zbrazëta se në cilin kontinent ndodhet secili nga shtetet e përmendura. Për ta bërë këtë, mund të përdorni hartën politike të botës që keni në faqen tjetër.
2. Përdorni tabelën tuaj në të cilën do të renditni shtetet: në kolonën e parë sipas numrit të banorëve, duke filluar nga më të shumtët të numëruar deri te më pak të numëruar, kurse në kolonën e dytë sipas sipërfaqes së territorit, duke filluar nga më i madhi te më i vogli. Do të vini re se nuk keni marrë të njëjtin rend të gjendjeve në të dyja kolonat. Pse është kështu? Cilat shtete kanë vend të përafërt në të dy kolonat e tua? Cili vend është më i dendur - më i madh sipas numrit të popullsisë dhe cili është më i madh sipas territorit që zë? Kontrolloni dhe përcaktoni se në cilin kontinent ndodhen dy shtete që janë më të mëdha për nga popullsia dhe nga sipërfaqja.
3. Në tabelë janë renditur edhe kryeqytetet e shtatë shteteve që janë më të mëdha sipas një karakteristike të caktuar. Jo secili prej tyre është më i madhi në vendin ku i përket, pavarësisht se është kryeqytet. Hulumto qytetet më të mëdha dhe shpjegoni se çfarë i bën ata më të mëdha. A është madhësia e territorit ose numri i popullsisë. Bëni një album në formë letre ose elektronike dhe prezantoheni në para klasës.

SHTETI	SIPËRFAQJA NË MILIONË KILOMETRA KATRORË	KRYEQYTETI	POPULLSIA (NUMRI I VLERËSUAR I BANORËVE) NË SHTET	KONTINENTI
Australia	7,69	Kanbera	26 milionë	
Brazili	8,51	Brazili	215 milionë	
Kina	9,70	Pekini	1,448 miliardë	
SHBA	9,37	Uashingtoni	334 milionë	
Kanadaja	9,98	Otava	38 milionë	
Rusia	17,09	Moska	145 milionë	
Algjeria	2,38	Algjeria	45 milionë	

(të dhëna nga viti 2022)

Pyetje:

1. Numëroji vendet më të mëdha nga çdo kontinent!
2. Bëj krahasim midis vendit më të madh sipas sipërfaqes dhe vendit më të madh sipas popullsisë. Nxirr një përfundim: A ka rol madhësia e sipërfaqes në numrin e banorëve të ndonjë shteti?
3. Prej se varet numri i banorëve në shtete?

¹ Vlerat e përafërta

² Vlerat e përafërta

Faktet për shtetet më të mëdha dhe për kryeqytetet e tyre

Kanadaja

Është vendi i dytë më i madh në botë dhe vendi më i madh në hemisferën perëndimore për nga sipërfaqja e përgjithshme, nëse merret parasysh sipërfaqja e ujit dhe tokës. Në fakt, Kanadaja është vendi me masën më të madhe ujore në territorin e saj në botë. Janë 1.6 milionë kilometra katrorë të mbuluara nga uji. Përveç kësaj, Kanadaja është vendi me numrin më të madh të kilometrave të vijës bregdetare në botë, me 202.080 kilometra. Kryeqyteti i Kanadasë është Otava. Qytet më i madh se Otava është Toronto.



A e keni ditur se

Kanadaja e ka marrë emrin nga fjala indiane kanata që do të thotë vendbanim, fshat.

- Popujt vendas të Kanadasë janë indianët dhe inuitët.



Otava



Toronto

SHBA

Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA) është shtet federal i përbërë nga disa shtete. Është vendi me sipërfaqen më të madhe tokësore në hemisferën perëndimore dhe i dyti më i madh me sipërfaqe pas Kanadasë. Territori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës gjendet pas Kinës dhe Brazilit, duke e bërë atë territorin e pestë më të madh në planet. Kryeqyteti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës është **Uashingtoni**, por Nju-Jorku dhe Los-Anxhelesi janë më të mëdha se ai (sipas sipërfaqes dhe numrit të banorëve).

**A e keni ditur se**

- Numri më i madh i banorëve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës janë emigrantë.
- Edhe pse anglishtja është gjuha më e folur e përdorur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe është gjuha e përdorur në qeveri, vendi nuk ka gjuhë zyrtare.



Uashingtoni



Nju-Jorku

Kina

Kina është vendi më i madh në Azi për nga popullsia dhe vendi i dytë më i madh në Azi për nga territori. Është vendi më i populluar në të gjithë botën me më shumë se 1.250.000.000 banorë.

Kina ka kufirin tokësor më të gjatë në botë dhe kufizohet me 14 vende. Kryeqyteti është **Pekini**, kurse qyteti më i madh në territorin e saj është Shanghai.



A e keni ditur se

- Kinezët shpikën: letrën, porcelanin, barotin, pëlhurën mëndafshin, busullën, letrën për para.
- Kina është e njohur sipas Murit Kinez, i cili u ndërtua si mbrojtje kundër ushtrive pushtuese.



Pekini



Shangai

Brazili

Brazili është vendi më i madh në Amerikën e Jugut dhe në të gjithë hemisferën jugore. Por, ai është gjithashtu territori më i madh i afërt me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, përpara Kanadasë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Kryeqyteti është **Brazilia**. Qytetet më të mëdha të Brazilit janë Sao-Paulo dhe Rio-de-Zhaneiro.



A e keni ditur se

Brazili është një nga prodhuesit më të mëdhenj të kafesë në botë.

Më se - 60% e pyjeve tropikale të Amazonës, të ashtuquajturat mushkëritë e planetit, gjenden në Brazil.



Brazilia



Rio-de-Zhaneiro

Australia

Australia është vendi më i madh në Australi dhe Oqeani. Është gjithashtu vendi më i madh pa dalje në det në botë dhe vendi më i madh në hemisferën jugore (Brazil ka territore në të dy hemisferat). Pjesa më e madhe e vendit është e shkretë ose gjysmë e thatë. Në fakt, Australia është vendi më i thatë dhënë i rrafshët i banuar në botë dhe vendi me tokën më pak pjellore. Vetëm pjesët juglindore dhe jugperëndimore kanë klimë mesatare, ku është e përqendruar pjesamë e madhe e popullsisë. Kryeqyteti është Kanbera. Përveç **Kanberës**, Sidnei dhe Melburni gjithashtu janë qytete të mëdha.



A e keni ditur se

- Kontinenti më i afërt me Australinë është Azia.
- Koalat dhe kangurët janë shenja mbrojtëse e Australisë.
- Shtëpia e Operës së Sidneit konsiderohet të jetë një nga ndërtesat më të bukura në botë në kohët moderne.



Kanbera



Shtëpia e Operës së Sidneit

Algjeria

Listën e vendeve më të mëdha në botë e plotëson shteti më i madh në Afrikë, Algjeria. Pjesa veriore e vendit përbëhet nga rrafshnaltat e madhe e zgjatur, në të cilën janë formuar shumë gropa, kurse veriu dhe jugu kufizohen nga vargmalet e larta malore. Kryeqyteti është **Algjeri**, kurse pranë tij, një nga qytetet më të mëdha është Orani.



A e keni ditur se

- Gjuhët zyrtare në Algjeri janë arabishtja dhe berberishja.
- Shkretëtira e Saharasë zë 80% të territorit të Algjerisë.
- Pavarësisht klimës së nxehtë, në rajone të caktuara të Algjerisë bie borë në dimër.



Qyteti i Algjerit

Rusia

Rusia është vendi më i madh në botë për nga sipërfaqja që e zë. Prandaj, sipërfaqja e saj zë 11% të sipërfaqes së Tokës. E vendosur midis dy kontinenteve, Rusia është vendi më i madh në Azi dhe Evropë. Kryeqyteti i Ruisë është Moska. Qytetet më të mëdha në Rusi janë Sankt Petersburgu, Novosibirsku, Ekaterinburgu, etj.



A e keni ditur se

- Për shkak të madhësisë së sipërfaqes, vendi ka deri në nëntë zona kohore.
- Liqeni i Baikalit, i vendosur në Rusi, është liqeni më i thellë në botë.
- Rusia është i vetmi vend në botë që kufizohet me 12 dete.

Aktivitet:

Ndahuni në grupe. Një grup është “agjenci turistike” dhe grupi tjetër janë “turistët”. Turistët i drejtohen agjencisë turistike për të organizuar një udhëtim në një kontinent të caktuar. Agjencia turistike ia planifikon udhëtimin, ua tregon shtetet dhe qytetet kryesore, numrin e popullsisë dhe shpjegon pse duhet t'i vizitojnë ato shtete dhe qytete. Të dy grupet përdorin hartën e botës për të përcaktuar destinacionet e tyre dhe për të hartuar se cilat vende dhe qytete duhet të vizitojnë.

Diskutoni për atë se cilat janë karakteristikat e atyre shteteve që keni zgjedhur. Kërkoni në internet disa destinacione turistike që dëshironi t'i vizitoni. Bëni flaer për destinacionet t uristike në shtetin që keni zgjedhur.



Moska

POPULLSIA, SIPËRFAQJA DHE VENDPOZITA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Shikoni hartën dhe përgjigjuni:

Në cilin kontinent ndodhet Republika e Maqedonisë së Veriut?




Republika e Maqedonisë së Veriut ndodhet në pjesën juglindore të kontinentit të Evropës. Ajo është pjesë e Gadishullit Ballkanik, por nuk del deri në det. Edhe pse vendi ynë është më i vogël për nga sipërfaqja dhe numri i banorëve në krahasim me vendet e tjera evropiane, ai sërish ka vendpozitë të volitshme. Përmes saj kalojnë rrugë të rëndësishme evropiane që e lidhin me vendet e tjera të Evropës si dhe me vendet e afërta të Afrikës dhe Azisë.

Mëso më shumë:

Gadishulli është sipërfaqe e madhe tokësore e rrethuar me ujë nga tri anët. Gadishulli është gjithmonë i lidhur me tokën kryesore.

Gadishulli Ballkanik përbëhet nga këto shtete: Republika e Maqedonisë së Veriut, Republika e Greqisë, Republika e Shqipërisë, Republika e Bullgarisë, Republika e Kosovës, Republika e Serbisë, Republika e Kroacisë, Republika e Sllovenisë, Republika e Malit të Zi, Republika e Bosnjës dhe Hercegovinës.

Republika e Maqedonisë së Veriut zë një sipërfaqe prej 25,713 km².



Në lindje vendi ynë kufizohet me Republikën e Shqipërisë, në veri me Republikën e Kosovës dhe Republikën e Serbisë, në perëndim me Republikën e Bullgarisë dhe në jug me Republikën e Greqisë.

Detyra nr. 1

Tabela e mëposhtme tregon të dhënat për sipërfaqen, numrin e banorëve dhe kryeqytetet e vendeve fqinje. Shikoni tabelën dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.

SHTETI	SIPËRFAQJA NË KILOMETRA KATRORË	NUMRI I BANORËVE	KRYEQYTET
Republika e Shqipërisë	28.748	2.8 milionë	Tiranë
Republika e Serbisë	88.361	8.6 milionë	Beograd
Republika e Kosovës	10.887	1.8 milionë	Prishtinë
Republika e Bullgarisë	110.879	6.8 milionë	Sofie
Republika e Greqisë	131.990	10.3 milionë	Athinë

- Cili nga vendet tona fqinje është më i madhi sipas sipërfaqes? Krahasoni me vendin tonë. Sa është dallimi?
- Cili nga vendet fqinje ka më shumë banorë? Krahasoni me vendin tonë. Sa është dallimi?
- Vizatoni një tabelë në të cilën do të renditni vendet fqinje, përfshirë edhe Republikën e Maqedonisë së Veriut, sipas sipërfaqes duke filluar nga vendi më i vogël. Në një tabelë tjetër krahasojini sipas numrit të banorëve. Çfarë vëreni, ku gjendet Republika e Maqedonisë së Veriut për nga sipërfaqja dhe ku gjendet për nga numri i banorëve?

Detyra nr. 2

Në hartën mëposhtme, shkruani emrat e vendeve dhe shënoni kryeqytetet e tyre.



Rezultatet e mësimit

Nxënësi do të aftësohet:

- të dallojë se si e kaluara e njerëzimit ndahet në dy periudha të mëdha kohore - parahistoria dhe historia, dhe të dallojë periudhat themelore në kuadër të parahistorisë dhe historisë;
- të shpjegojë si llogaritet koha në të kaluarën dhe si llogaritet në ditët e sotme;
- të dallojë llojet themelore të burimeve historike dhe të japë shembuj për secilin prej tyre;
- të japë shembuj të vendeve të njohura arkeologjike në botë dhe në territorin e vendit tonë dhe t'i gjejë në kohë dhe në hapësirë.

Gjithashtu do të kuptojë se:

- Vendzbulimet arkeologjike janë të rëndësishme për të kuptuar historinë e botës.

PARAHISTORIA DHE HISTORIA

PERIUDHAT HISTORIKE:

- Periudhat kohore
- Ndarja e së kaluarës
- Parahistoria:
 - Koha e gurit
 - Koha e metaleve
- Paraqitja e letrës
- Historia:
 - Koha e vjetër/historia e lashtë
 - Mesjeta/koha e mesjetës
 - Koha e re/historia moderne
 - Koha më e re/historia bashkëkohore

NUMËRIMI I KOHËS GJATË HISTORISË

- Kalendarët gjatë historisë
- Kalendari Julian dhe Gregorian

BURIMET HISTORIKE

VENDZBULIMET E NJOHURA ARKEOLOGJIKE NË BOTË

VENDZBULIMET ARKEOLOGJIKE NË TERRITORIN E VENDIT TONË


PERIUDHAT HISTORIKE

Periudhat kohore



Mendo dhe përgjigju:

- Përcakto në cilin shekull, cilën dekadë dhe cili mijëvjeçar i përket vitit në të cilin je lindur!
- Sa ditë zgjat një vit? Sa ditë kanë kaluar nga fillimi i vitit deri në ditëlindjen tënde?
- Përkujtohu sa vite ka një dekadë dhe sa dekada ka një shekull? Pastaj, përcakto sa shekuj dhe sa vite ka një mijëvjeçar.
- A je lindur ti dhe prindërit/kujdestarët e tu në të njëjtin shekull? E jeni lindur në të njëjtin mijëvjeçar?



Keni arritur në përfundimin se për të mësuar të kaluarën është shumë e rëndësishme të dini se kur kanë ndodhur ngjarjet dhe të jeni në gjendje të llogarisni saktë distancën e ngjarjeve, parë nga këndvështrimi i sotëm. Për shembull, një vit ka 365 ditë, një dekadë ka 10 vite rresht, një shekull është një periudhë prej 100 vitesh rresht (10 dekada), një mijëvjeçar është periudhë prej 1000 vitesh rresht (10 shekuj rresht).

A është lehtë? Keni vërejtur se përcaktimi i periudhave kohore ka të bëjë shumë me matematikën. Kështu, shekulli i parë fillon me vitin e parë dhe mbaron me të qindtin, shekulli i dytë fillon me vitin 101 dhe mbaron me të dyqindtin, etj. Për ta bërë më të qartë për ju, do të ushtrojmë përmes shembujve specifikë:

Detyrë

Punoni në grupe dhe përcaktoni se cilit mijëvjeçar dhe cilit shekull i përkasin vitet e dhëna. Pas përcaktimit të shekullit, përcaktoni gjithashtu se në cilën dekadë të shekullit janë vitet. Për shembull, viti 2022 është në mijëvjeçarin e tretë, në shekullin XXI dhe në dekadën e tretë të shekullit XXI. Vazhdoni në grup për vitet në vijim, duke plotësuar tabelën e mëposhtme.

VITI	MILENIUMI	SHEKULLI	DEKADA
viti 1973			
viti 2000			
viti 969			
viti 1014			
viti 1394			
viti 168			

Duke studiuar të kaluarën e njeriut, shpesh do të hasesh me termin erë (epokë). Era është periudhë shumë e gjatë kohore në historinë e Tokës. Në kuptimin historik të fjalës, llogaritja e kohës përcaktohet në dy era, sipas lindjes së Jezu Krishtit. Për ngjarjet që kanë ndodhur para lindjes së Jezu Krishtit themi se kanë ndodhur **para erës së re (p.e.r.)**, kurse për ngjarjet që kanë ndodhur pas lindjes së Jezu Krishtit themi se kanë **ndodhur në erën e re (e.r.)**. Shumica e vendeve në botë sot e praktikojnë këtë mënyrë të numërimit të kohës. Vitet para erës së re numërohen mbrapsht, duke llogaritur nga më i madhi te më i vogli, për shembull: viti 225, viti 224, viti 223 etj. Vitet e erës së re i llogarisim përpara, nga më i vogli te më i madhi, për shembull: viti 2005, viti 2006, viti 2007 etj.




Figura: Afati kohor i dhënë në vite

Nuk ekziston asnjë "shekull zero" apo vit zero midis shekullit të I para Krishtit dhe shekulli I pas Krishtit. Shekulli i parë p.e.r. zë periudhën nga viti 100 p.e.r. deri në vitin 1 p.e.r. Shekujt e tjerë para erës së re ndjekin të njëjtin model. Është shumë e ngjashme me matjen e temperaturës së ajrit, vetëm se nuk ka zero gradë. Sa më i madh të jetë numri minus, aq më e ulët është temperatura.


Nga pikëpamja historike, sa më i lartë të jetë numri para erës së re, aq më e largët është e kaluara për të cilën flitet. Në erën e re shekujt nisin nga 1 janari i vitit të parë dhe përfundojnë me rrumbullakimin e njëqindës, më 31 dhjetor. Për shembull, shekulli XX fillon më 1 janar të vitit 1901 dhe përfundon më 31 dhjetor të vitit 2000.

Detyrë

Lidhi figurat e njohura historike me shekullin që i përkasin në afatin kohor. Paraprakisht, hulumtoni se në cilën periudhë kohore ai/ajo ka vepruar.



Kleopatra
(Mbretëresha e
Egjyptit)



Arkimedi
(matematicieni i lashtë)



Nënë Tereza
(misionare dhe
humanitare)



Fernando Magelani
(lundërtar dhe
hulumtues)



Pyetje:

1. Në cilin shekull dhe cilin mijëvjeçar po jetojmë sot?
2. Si përcaktohen periudhat kohore në histori?
3. Trego nga një ngjarje historike të rëndësishme që ka ndodhur para erës së re dhe nga era e re.

Ndarja e së shkuarës



Mendo dhe përgjigju:

- Shpjego thënien: “Historia është mësuesja e jetës”.
- Pse thuhet kështu?




Pa histori nuk do të dinim veprat më të mira të të parëve tanë, të cilët janë heronjtë e së kaluarës sonë, çfarë do të ishte më e rëndësishme në jetën e tyre. Pa histori nuk do të dinim se si ka ndryshuar bota dhe si mund të ndryshojë. Në fakt, mësimi dhe kuptimi i së kaluarës na ndihmon të kuptojmë të tashmen dhe të krijojmë kushte më të mira jetese.

Fjala histori përdoret për të shpjeguar diçka që ka ndodhur në të kaluarën, për ngjarjet e kaluara, dukuritë dhe ndryshimet në jetën dhe aktivitetet e njerëzve. Kështu quhet edhe shkenca që mëson të kaluarën e shoqërisë njerëzore, që nga krijimi i njeriut e deri në ditët e sotme. Kjo do të thotë se historia është term që tregon informacion për të kaluarën.

E kaluara e njeriut ndahet në dy periudha të mëdha: **parahistoria dhe historia**.

Parahistoria zgjati disa miliona vjet. Nuk mund të përcaktohet saktësisht se kur filloi, por ne e dimë se parahistoria mbulon periudhën nga shfaqja e njeriut deri në shpikjen e shkrimit.

Historia përfshin periudhën nga zbulimi i letrës deri në ditët e sotme. Filloi rreth 4000 vjet para erës së re dhe vazhdon ende.



Mendo dhe përgjigju:

- Sa vite gjithsej zgjat deri më sot periudha e historisë?

Parahistoria



Përmendëm se parahistoria është periudha më e gjatë e së kaluarës së njerëzimit. Gjatë asaj periudhe të gjatë kohore u shfaqën paraardhësit më të vjetër të njerëzve të sotëm. Njeriu parahistorik ishte mbledhës i ushqimit dhe gjuetar. Pastaj filloi të kultivonte bimë dhe të zbuste kafshët. Mësoi të përdorte zjarrin, harkun, shigjetën dhe vegla të ndryshme. Në periudhën më të vjetër të parahistorisë njeriu përdorte vegla dhe armë guri dhe më vonë zbuloi metalin. Nga ajo periudhë e gjatë janë ruajtur pak mbetje, edhe atë: vegla guri, armë, pjesë vendbanimesh, varre me eshtra, pjesë enësh e të tjera. Për jetën e njeriut në kohën parahistorike mësojmë vetëm nga mbetjet materiale.

Në temën e fundit përmendëm procesin e evolucionit njerëzor, i cili u zhvillua ngadalë dhe gradualisht. Ka dëshmi të zhvillimit të saj që nga kohërat më të hershme në territorin e vendit tonë.

Sipas asaj se çfarë vegla ka përdorur njeriu në një periudhë të caktuar, parahistoria ndahet në: kohën e gurit dhe të metalit.

Me siguri parashtroni shumë pyetje, të cilat në kohën e sotme të teknologjisë dhe komunikimit me botën janë të pakuptueshme. Për shembull: si jetonin njerëzit? Më çka janë ushqyer? Si dukeshin vendbanimet e tyre?

Koha e gurit

Në periudhën më të vjetër dhe më të largët, të quajtur koha e gurit, njerëzit e përdornin gurin si mjet për punë, edhe atë sikurse e gjenin në natyrë. Më vonë, pas shumë shekujsh dhe me kalimin e viteve mësuam se si ta përpunojnë gurin dhe t'i japin forma të ndryshme sipas nevojave të tyre. Nga guri bënë thika dhe sëpata. I përdornin gjithashtu kockat e kafshëve dhe prej tyre bënë thumba, gjilpëra dhe zbukurime.



Sendet parahistorike prej guri, kockave dhe lëkurës e kafshëve

Në fillim, njerëzit parahistorikë jetonin në grupe të vogla, në shpella. Ata hanin kafshë që gjuanin, si dhe fruta dhe rrënjë të bimëve që gjenin në natyrë.

Pse mendoni se paraqitja e të folurit ishte një nga përparimet më të rëndësishme për njerëzit parahistorikë?

Meqenëse njerëzit parahistorikë ishin gjuetarë, frika nga kafshët e egra dhe marrja e ushqimit ishte problem i madh për ta. Ata kishin frikë edhe nga dukuritë natyrore, sepse nuk dinin ta shpjegonin ekzistencën e tyre.



Hulumto

Si e zbuluan zjarrin njerëzit parahistorikë?

Vëren se në fillim njerëzit vraponin dhe fshiheshin nga zjarri, kurse më vonë, kur zbuluan se sa i dobishëm ishte, filluan ta mirëmbajnë. Kanë kaluar shumë vite që kur njerëzit mësuhan të ndezin zjarrin duke fërkuar degë të thata ose shkëndija nga gurët. Kjo nuk ishte aq e thjeshtë, por ia dolën. Tas hmë mund të piquin mish, të zhvendoseshin në rajone më të ftohta, të ndryshonin formën e sendeve duke i ngrohur ato, të bënin enë nga balta të cilat i piquin. Zbulimi i zjarrit ndikoi shumë në zhvillimin e hoqërisë. Njerëzit filluan të ndërtonin banesa, të mos e ndërrojnë vendbanimin, të zbutin dhe të rritin kafshë dhe gradualisht nga gjuetarë të kalojnë në barinj.

A e keni ditur se

Kafsha e parë e zbutur nga njeriu që në kohët e lashta ishte qeni. Përveç mikut më të mirë, qeni u bë edhe miku më i vjetër i njeriut.



Barinjtë dhe bujqit parahistorikë



Rindërtimi i vendbanimit mbi hunj
(Gjiri i Kockave - Ohër)

Bujqit dhe barinjtë e parë ndërtuan vendbanime të përhershme në tokë dhe në ujë (vendbanime mbi hunj), më vonë shtëpi të thjeshta të bëra me degë dhe baltë.

Njerëzit filluan të jetojnë në komunitete më të mëdha ku të gjithë ishin të lidhur.

Bashkësitë e tilla quhen klan. Mendohej se një klan e kishte prejardhjen nga një paraardhës i përbashkët. Pavarësisht se në këto komunitete parahistorike të gjithë njerëzit ishin të barabartë, nëna, gruaja, kishte një vend veçanërisht të rëndësishëm në këto komunitete dhe ishte shumë e respektuar.

Mëso më shumë

Bashkësi të tilla njerëzore, në të cilat gratë kishin një rol udhëheqës, quhen matriarkat. Cilat janë emrat e komuniteteve njerëzore në të cilat burrat luajtën një rol udhëheqës?

Zbulimi i rrotës gjithashtu kontribuoi në zhvillimin më të shpejtë të komuniteteve në të cilat jetonin njerëzit parahistorikë. Rrota e kohës së gurit nuk pati ndonjë rol të rëndësishëm në zhvillimin e shoqërisë, sepse e përdorën atë si rrotë për të bërë qeramikë. Ishte vetëm shumë më vonë që u zhvillua si një shpikje që do të lehtësojë jetën e njerëzve dhe do të kontribuojë në zhvillimin e shpejtë të shoqërisë.



Rrota për ndreqje të enëve të qeramikës

**Mendo dhe përgjigju:**

- Pse njerëzit në të kaluarën e largët ndërtonin vendbanime mbi ujë? Nga çfarë mbroheshin?
- Sipas fotografive të dhëna imagjinoni dhe përshkruani një ditë për njerëzit në kohën e gurit.





Pyetje:

1. Si ndahet periudha e parahistorisë? Pse është ndarë kështu?
2. Cilat janë zbulimet më të mëdha të kohës së gurit?
3. Si ndikoi përdorimi i fjalës në jetën e njerëzve të kohës së gurit?
4. Çfarë kontribuoi që njerëzit në kohët parahistorike të fillonin të merreshin me blegtori dhe bujqësi?

Koha e metaleve

Në kërkim të një guri të përshtatshëm për përpunim, njerëzit në kohët parahistorike rastësisht gjetën lloje të ndryshme xeherore nga të cilat merrnin metale. Prandaj kjo periudhë më e zhvilluar e parahistorisë quhet epoka e metaleve.

Para së gjithash, ata gjetën bakrin dhe filluan të bëjnë vegla dhe armë prej tij. Problemi ishte se bakri është shumë i butë, kështu që veglat e bëra prej tij lakoheshin lehtësisht. Kërkimi për metale të reja i çoi njerëzit parahistorikë drejt kallajit. Kur e gjeti kallajin, njeriu filloi ta përziehte me bakër dhe ata përfituan një metal të ri dhe më të fortë - bronzin. Veglat dhe armët prej bronzi ishin më të forta dhe më të qëndrueshme. Zhvillimi më i madh dhe më i shpejtë i njerëzimit në kohët parahistorike ka shkaktuar zbulimin dhe përdorimin e hekurit.



Sende parahistorike nga metali



Mendo dhe përgjigju:

- Cili ishte roli i metaleve në jetën e njeriut në kohët parahistorike?
- Çfarë ndryshimesh shkaktoi zbulimi i tyre? Emërtoni disa sende metalike që keni në shtëpi dhe në shkollë. A mund ta imagjinojë njeriu sot jetën pa përdorimin e metaleve?

